

VËRTETËSIA

Botim i Xhematit Musliman Ahmedia të Shqipërisë

Nr.7

ÇELËSI I PAQES, BASHKIMI GLOBAL

FJALIM HISTORIK I MBAJTUR
NË PARLAMENTIN EVROPIAN



Tri shkallët e mirësisë;
tri shkallët e ligësisë

4

Rruga drejt paqes -
marrëdhëniet e drejta
midis shteteve

18

Profeti Muhammed^{sa}
në sytë e intelektualëve

34

Parimet e interpretimit
të ëndrrave

90

Tani, çdo të premtë...

ndiqni fjalimin e xhumasë në shqip,
të mbajtur nga Hazret Kalifi i Pestë
i Mesihut të Premtuar.

Vizitoni: www.alislam.al




“Nuk barazohet
e mira me të keqen.
Të keqen largoje
me atë që është
më e mira,
atëherë ai që ka
armiqësi ndaj teje,
menjëherë
do të të bëhet
mik i ngushtë”.

(Kurani Famëlartë 41:35)

VËRTETËSIA numri VII

një hap më pranë argumentit dhe rrugës së drejtë

PËRMBAJTJA




4



18



74



16

- 4 Tri shkallët e mirësisë; tri shkallët e ligësisë**
Komentim i Kuranit Famëlartë
Nga Hazret Mirza Mahmud Ahmedi ^{r.a.}, Kalif i Dytë i Mesihut të Premtuar
- 13 Mos iu afroni gjërave të ndaluara!**
Thënie e Profetit Muhammed ^{s.a.}
- 16 Miqësia me Zotin e Madhërishëm**
- 18 Rruga drejt paqes,**
Marrëdhëniet e drejta midis shteteve
Fjalimi historik i Hazret Mirza Masrur Ahmedit, Udhëheqës botëror i Xhematit Musliman Ahmedia, i mbajtur në Senatin e Amerikës, Capitol Hill.
- 34 Profeti Muhammed ^{s.a.} në sytë e intelektualëve**
- 44 Liria fetare e Hazret Omerit ^{ra}, Kalif i Dytë i Profetit Muhammed ^{s.a.}**
- 48 Çelësi i paqes - bashkimi global**
Fjalim historik i Hazret Mirza Masrur Ahmedit, Udhëheqës botëror i Xhematit Musliman Ahmedia, i mbajtur në Parlamentin Evropian, Bruksel.



48



34

74 Si mund të arrihet paqja me vetveten?

84 Xhemati Musliman Ahmedia në Gjermani merr statusin e një shoqërie me të drejta publike

86 Xhemati Musliman Ahmedia në Afrikë

90 Parimet e interpretimit të ëndrrave

Pyetje-përgjigje

Transkriptim i një sesiioni pyetje-përgjigjesh të mbajtur nga Hazret Mirza Tahir Ahmedi^{r.a.}, Kalifi i IV i Mesihut të Premtuar.

Kryeredaktor:

Samad Ghorri

Zv. kryeredaktor:

Shahid Ahmad Butt

Redaktore gjuhësore:

Ina Komino

Anëtarë:

Javaid Iqbal Nasir,

Bujar Ramaj

Grafika:

Petani design

Shtypur në shtypshkronjën:

Gent•grafik

Tiranë, mars 2014

Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë, pranë Vodafonit, Rr.

“Pavarësia” Km. 1, Mëzez,
Kutia Postare 8176, Tiranë,
Shqipëri

Tel: +355(0)682974992;
0692994966; 0666619831;
+355(0)42391080

Fax: +355(0)42391081

E-mail:

vertetesia@gmail.com

Uebfaqja:

www.alislam.al

www.vertetesia.al

Komentim i Kuranit Famëlartë



Tri shkallët e mirësisë; tri shkallët e ligësisë

Nga Hazret Mirza Mahmud Ahmedî ^{r.a.},
Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَايَ ذِي الْقُرْبَىٰ
وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ
بِعِظَمِ لَعْنَتِهِمْ تَذَكَّرُونَ

“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe dashamirësinë si ajo që u tregohet të afërmve, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju të kuptoni”.¹

1. Kurani Famëlartë 16:91

Në ajetin e mëparshëm, Kurani Famëlartë bën deklaratën:

وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ تِبْيَانًا لِّكُلِّ شَيْءٍ
وَهُدًى وَرَحْمَةً وَبُشْرَىٰ لِلْمُسْلِمِينَ

“Ne ta zbritëm ty librin si shpjegim për çdo gjë, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të gëzueshëm për të bindurit”.²

Katër veçoritë e Kuranit Famëlartë

Kurani Famëlartë ka këto katër veçori: **(1) ai është shpjegim për çdo gjë, (2) është udhërrëfyes, (3) është mëshirë dhe (4) është lajm i gëzueshëm për të bindurit.** Ndërsa në ajetin që po komentojmë si dhe në ajetet që janë në vijim, paraqiten dëshmi që Kurani Famëlartë i ka këto katër cilësi dhe në bazë të kësaj, nuk mund të dyshohet nëse ky libër është i suksesshëm.

Dëshminë e parë e jep pikërisht ky ajet, madje, sipas meje, i vetëm ky ajet siguron mjaftueshëm prova për të katër veçoritë.

2. Kurani Famëlartë 16:90

Në këtë ajet, janë porositur tri gjëra dhe po ashtu, tri gjëra janë ndaluar. Ndalimi nga gjërat e këqija ndryshe quhet **mëshirë** dhe porosia për gjërat e mira quhet **udhërrëfim**. Sërish, në këtë ajet janë përmbledhur të gjitha nivelet e moraleve, gjë që e bën të përsosur dhe në këtë mënyrë ai bëhet shembull i veçorisë, **shpjegim për çdo gjë**. Pastaj ajeti përfundon me fjalët **لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ** “në mënyrë që ju të kuptoni”. Fjala **تذكر** *tedhekur* vjen nga folja **ذكر** *dhequera*, e cila ka kuptimin “*kujtoj*”, ose *përkujtoj madhështinë e Zotit*. Pra **لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ** do të thotë “në mënyrë që ju t’i kujtoni detyrimet që keni ndaj Zotit të Lartësuar dhe ndaj robërve të Tij”, ose “në mënyrë që ju ta përkujtoni lavdërimin dhe madhështinë e Zotit”. Në fakt, këto janë dy qëllimet, për të cilat është krijuar njeriu, prandaj ky ajet përmban edhe **lajmin e gëzueshëm** që nëse do ta ndiqni, do ta gjeni qëllimin e krijimit tuaj.

Shikoni sesa i shkurtër është ky ajet, por që hedh dritë mbi të gjitha ato gjëra, të cilat janë treguar si veçoritë e Kuranit Famëlartë. Asnjë libër tjetër nuk na sjell një shpjegim

të tillë, me kaq pak fjalë. Asgjë nuk është e fshehur apo e pakuptimtë. Tema është shumë e qartë dhe e kuptueshme për çdo të mençur.

Tani, do ta shpjegoj pak më hollësisht temën e këtij ajeti. Dihet që në botë çdo gjë ka dy anë: pozitive dhe negative. Asgjë nuk mund të përsoset, derisa nuk plotësohen të dyja anët e saj. Domethënë një gjë e caktuar duhet të ketë të gjitha gjërat që janë të nevojshme për përsosmërinë e saj dhe njëkohësisht të jetë e pastër nga çdo e metë.

Kriteret e një mësimi të përsosur

Kur flasim për fenë, për një mësim të përsosur, janë të nevojshme këto gjëra:

Së pari, mësimi që pretendon të jetë i përsosur duhet të porosisë për ato gjëra, që e çojnë spiritualitetin e njeriut drejt përsosmërisë dhe t'i ndalojë ato që e pengojnë spiritualitetin e tij të shkojë drejt së përkryemes.

Së dyti, ai mësim të paraqesë një kod, i cili të mos jetë i kufizuar vetëm te një njeri, apo te një popull, por të jetë për shumë njerëz dhe shumë popuj. Pra, ai duhet të mbulojë nevojat e njerëzve të çdo natyre. Mësimet e tij të jenë të tilla që çdokush, sipas aftësive të tij, t'i ndjekë ato.

Së treti, ai mësim të japë porosi që duhet të jenë të zbatueshme nga njerëzit. Pra, të mos shkaktohet ndonjë çrregullim nga ai, as në fe e as në moral, as në mendjen e as në kulturën e njeriut.

Tri nivelet e mirësisë dhe tri nivelet e ligësisë

Zoti i Lartësuar i ka përmbledhur të tria këto veçori në këtë ajet të vetëm. Vëreni se sa i shkurtër është ky ajet, por me çfarë mjeshtërie përmbledh të dy faktorët (pozitivin e negativin) e përsosmërisë. Ajeti porosit për tri gjëra, që janë: **drejtësia (edl)**, **mirësia (ih-san)** dhe **dashamirësia si ajo që ka një i afërm (itaidhil kurba)**. Po ashtu, ai ndalon tri gjëra: **imoralitetiin (fahsha-në)**,

veprën e shëmtuar (*munker-in*) dhe dhunën (*beg'ji-n*).

Edli do të thotë barazim, njeriu të sillet me tjetrin ashtu siç duhet. Nëse atij i bëhet padrejtësi, atëherë ai ka të drejtë të marrë hakun, por vetëm aq sa i ishte bërë padrejtësi, e jo më shumë. Po ashtu, nëse dikush i bën ndonjë nder, atëherë edhe ai ka për detyrë t'ia kthejë nderin me nder, që duhet të jetë të paktën i barabartë me favorin e bërë nga tjetri.

Kur bëhet fjalë që të bësh drejtësi me Zotin e Lartësuar, do të thotë që ashtu siç Zoti është sjellë me mirësi me njeriun, edhe njeriu t'i përmbushë detyrimet

që ka ndaj Tij dhe të mos lërë ndonjë mangësi në to. Po ashtu, të mos ia japë të drejtën e Zotit dikujt tjetër, pra të mos bëjë *shirk*, sepse edhe *shirku* këtë kuptim ka: të drejtën që i takon Zotit, t'ia japësh dikujt tjetër.

Kjo është padrejtësi. Për këtë arsye në Kuranin Famëllartë *shirku* është konsideruar si padrejtësi. Prandaj, t'i caktosh bashkëshorte e bijë Zotit të Lartësuar, apo t'i shoqërosh dikë duke bërë *shirk*, nuk mund të jetë drejtësi, por përkundrazi, është padrejtësi me Zotin. Në të njëjtën mënyrë, t'ia etiketosh atributet e tjera të Zotit vetes gjithashtu është padrejtësi. Nëse njeriu do të bëjë drejtësi me Zotin e Lartësuar, në të gjitha çështjet,

Në këtë mënyrë, ky ajet përbën gjithë planin mësimor të përsosmërisë shpirtërore, me ndjekjen e të cilit, njeriu mund të arrijë në nivelin e shtatë, ku zhvillimi i tij përsoset. Njerëzit që janë të zhytur në llumin e ligësive të kategorisë *dhunë*, duke u munduar kalojnë në baltën e *veprës së shëmtuar*. Pastaj nga atje, nëse përpiqen mund të dalin për të kaluar në pluhurat e *imoraliteteve*. Kur pastrohen edhe nga ato, do të gjenden në stepën e *drejtësisë*. Kur ecin më lart, dalin në lëndinë e *mirësisë* dhe, nëse përparojnë akoma më shumë, do të mbërrijnë në *mirësinë amënore*, në një kopsht ku rrjedhin lumenj dhe burime. Më tej shtrihet vetëm xheneti. Me këtë kuptim Profeti Muhammed ^{s.a.} kishte thënë: “*Xheneti gjendet nën këmbët e nënave*”.

atëherë *shirku*, mohimi, mosbindja etj., të gjitha këto do të zhduken nga bota.

Pas drejtësisë vjen shkalla e mirësisë apo e favorit (*ihsan*). *Ihsani* do të thotë që nuk duhet të kesh parasysht se si sillet tjetri me ty. Madje, ai edhe nëse sillet keq, ti duhet t'ia kthesh me të mirë. Dihet që kjo shkallë është më e lartë sesa ajo e para. Falja dhe anashkalimi i gabimeve të tjerëve, dhënia e ndihmave dhe lëmoshave, shërbimet kombëtare apo shoqërore etj., të gjitha këto virtyte hyjnë në kategorinë e *Ihsanit*. Përveç këtyre, lëvrimi dhe studimi i shkencave të ndryshme gjithashtu bëjnë pjesë në mirësi, sepse nëpërmjet tyre, njeriu u sjell dobi dhe mirësi, materialisht dhe shpirtërisht, njerëzve të tjerë, të cilët mund të jenë të afërmit e tij, por mund të jenë edhe të panjohur.

Shkalla e tretë është e *itaidhil kurbasë*, që do të thotë “*të dhënit ndaj të afërmeve*” apo “*të dhënit e të afërmeve*”, dhe kuptimi i ajetit është që njeriu t’u shërbejë njerëzve të tjerë, ashtu siç u shërben të afërmeve

të tij. Kjo sjellje nuk është vetëm si sjellja me mirësi, siç u përmend më lart. Kjo është ajo sjellje që buron nga dashuria natyrore, e cila rrjedh pa prituri ndonjë shpërblim. Njeriu kur i bën dikujt ndonjë nder, normalisht merr parasysht edhe favorët e tjetrit dhe, duke u nisur nga kjo, dëshiron t’i bëjë diçka më shumë, në mënyrë që ai të jetë mirënjohës. Po kështu, kur i fal ndonjë gabim dikujt, ai kujton se nga ky veprim, tjetri do të pastrohet nga çdolloj urrejtjeje apo pakënaqësie nëse ushqente diçka të tillë ndaj tij dhe kështu do të bëhet mik i ngushtë, dhe pse jo, i shtohet edhe forca në këtë mënyrë. Por, një nënë kur e do fëmijën e saj ose edhe kur sakrifikon për të, kurrsesi nuk pret ndonjë grimë shpërblimi. Për një grua që nuk ka fëmijë, dëshira për ta pasur një nuk buron nga shpresa për shpërblim. Përkundrazi, kjo dëshirë buron nga nevoja për t’i shërbyer këtij fëmije, për ta ushqyer, për ta rritur, për ta veshur; ta martojë e më pas të rrisë edhe nipërit e mbesat që do të vijnë përmes tij. Pra, nëna që dëshiron trashëgimtar, nuk pret aspak me shpresë që fëmija më vonë t’i shërbejë asaj, por ajo mban

një dëshirë të zjarrtë për t'i shërbyer fëmijës. Dashuria e saj ndaj fëmijës bazohet në sakrificat e saj. Kjo është pikërisht ndjenja më e lartë e mirësisë që njeriu mund të arrijë, dhe vetëm atëherë morali i tij përsoset. Zoti i Lartësuar, në Kuranin Famëlartë thotë që pasi të keni arritur shkallën e dytë, atë të mirësisë dhe të favorit, duhet të përparoni akoma më shumë për të arritur edhe atë shkallë, në të cilën, ju më shumë dëshirë do të keni për të dhënë sesa për të marrë; kur të gjithë njerëzit t'i shihni me një ndjenjë amënore; kur dëshirën për t'u shërbyer atyre ta keni ashtu të fortë, siç mund ta ketë një nënë për t'i shërbyer fëmijës së vet.

Mësimi që u përmend më lart, trajton anën pozitive dhe me fjalë shumë të shkurtra mbledh të gjitha nivelet e moralit. Edhe një gjë tjetër që duhet të dihet këtu është se detyrimet që ka njeriu ndaj Zotit të Lartësuar shkojnë deri në shkallën e drejtësisë, pasi askush nuk mund t'i bëjë Zotit favor apo mirësi amënore. Por, për sa u përket marrëdhënieve me njerëzit, Kurani ia porosit njeriut të tria mësimet: drejtësinë, mirësinë

dhe dashamirësinë amënore. Pra, dy të fundit kanë lidhje vetëm me detyrimet që njeriu ka ndaj krijesave të tjera. Kjo nënkupton që për të arritur te Zoti i Lartësuar dhe për të gjetur kënaqësinë e Tij, shërbimi ndaj njerëzimit është i domosdoshëm, thënë ndryshe, dy nivelet e fundit janë dy shkallët që ia mundësojnë njeriut afrimin me Zotit.

Pasi përmendi këtë mësim pohues, Kurani Famëlartë trajton edhe anën negative, të cilën gjithashtu e ndan në tri shkallë. Pra, ai na ndalon nga tri gjëra: *fahsha'*, *munkeri* dhe *bagji*. Gjëja e parë që Kurani e ndalon është *imoraliteti (fahsha')*. Kur fjala *fahsha'* pason edhe fjalën *munker*, ajo nënkupton vetëm atë të keqe, që mund ta dijë vetëm vepruesi dhe jo dikush tjetër.

Pastaj, Kurani ndalon *veprën e shëmtuar (munker-in)*, e cila përfshin të keqen që mund ta shohin edhe të tjerët, ndaj së cilës ata shprehin edhe pakënaqësi, edhe pse ajo thuajse nuk ndikon mbi të drejtat e tyre. Për shembull: sharjet, gënjeshttrat, etj., të gjitha këto përfshihen në fjalën

munker. Pra, Kurani ndalon *munker-in*, sepse ai shkakton dëmtime dhe trauma psikologjike te të tjerët.

Gjëja e tretë, të cilën Kurani e ndalon është *dhuna (beg'ji)*, që do të thotë t'i rrëmbesh të drejtën dikujt. Njerëzit jo vetëm që e ndiejnë këtë të keqe, por edhe dëmtohen nga kjo.

Të këqijat që ekzistojnë në botë, që të gjitha përfshihen në këto tri kategori. E keqja ose mund të jetë e fshehtë, që njerëzit e tjerë nuk e dallojnë dot; ose atë mund ta dallojnë të tjerët, por përveç ndonjë dëmtimi psikologjik ata nuk pësojnë drejtpërdrejt ndonjë dëm nga ajo; ose ajo mund të jetë kaq e rëndë, sa që njerëzit e tjerë sfiliten nga ajo. Kurani Famëlartë, në këtë ajet, na ndalon nga të tria llojet e të këqijave.

Siç e kam shprehur më lart, mësimi i përsosur që përfshin të gjitha nevojat, duhet të ketë në konsideratë njerëzit e të gjitha natyrave. Mësimi që është dhënë në këtë ajet e ka edhe këtë veçori. Sepse, në botë ka njerëz që përfshihen në mëkate, të cilat hyjnë në kategorinë *fahsha*, edhe pse,

atyre në asnjë mënyrë nuk u pëlqen padrejtësia. Po ashtu, ka shumë të atillë që mizorisht u marrin paratë të tjerëve, por e urrejnë gënjeshtren. Ka edhe shumë të tillë që nuk u marrin të drejtat të tjerëve, por përfshihen në shumë të këqija të tjera, që Kurani i kategorizon në ato mëkate, të cilat cenojnë formimin personal të njeriut, si për shembull: të kesh mëri ndaj dikujt, të përgojosh apo të spiunosh dikë etj. Allahu i Lartësuar, duke përdorur tri fjalë të duhura, i kategorizoi të gjitha llojet e të këqijave, cilëso natyre njerëzore t'i përkasin ato.

Në të njëjtën mënyrë, edhe për të mirat, Allahu i Lartësuar i përmbledh të gjitha natyrat njerëzore: drejtësinë; mirësinë; dhe mirësinë me ndjenjë amënore.

Përveç kësaj, në këtë formulim të shkurtër, Ai ka treguar se cila është mënyra për t'iu larguar të këqijave dhe cila është mënyra për të përvetësuar të mirat. Kështu që, duke kategorizuar të mirat, Ai përmend tri shkallë, nga më e ulëta deri te më e larta. Edhe tri kategoritë e të këqijave kështu i ndan: nga më e vogla deri

te më e madhja. Me këtë hierarki, Zoti i tregon njeriut mënyrën më të natyrshme për të përvetësuar të mirat dhe për të hequr dorë nga të këqijat. Një njeri që dëshiron të përparojë drejt të mirave, më së pari ai duhet të përvetësojë drejtësinë, pastaj mirësinë e pastaj mirësinë me ndjenja amënore. Kurse për të këqijat njeriu duhet të qëndrojë larg nga e keqja më e madhe deri tek ajo më e vogla: së pari të heqë dorë nga *dhuna* (*beg'ji*), pastaj nga *vepra e shëmtuar* (*munkeri*) dhe pastaj nga *imoraliteti* (*fahsha*). Përveç kësaj, Zoti lajmëron se cila është shkalla, nga e cila mund të biesh nga mirësia e lartë në një mirësi më të ulët. Njeriu që qëndron në shkallën e tretë të të mirave, pra në shkallën e mirësisë më të sinqertë, ai duhet të tregohet i qëndrueshëm, përndryshe rrezikon të bjerë në shkallën e dytë, e cila është ajo e mirësisë si favor. Ndërsa ai që qëndron në shkallën e dytë të mirësisë, edhe ai duhet të tregohet i paluhatshëm në sjelljen e tij, përndryshe rrezikon të bjerë në shkallën më të vogël që është ajo e drejtësisë. Duke u nisur nga kjo ide, njeriu që gjendet në shkallën

më të vogël të të këqijave, pra të *imoraliteteve*, nuk duhet të gëzohet duke kujtuar se ai është një njeri i pastër, sepse duke bërë mëkatet e kësaj kategorie, ka mundësi të bjerë në kategorinë e dytë të të këqijave të *veprat e shëmtuara* (*munker*) dhe nga atje radhazi të bjerë në kategorinë e fundit të mëkateve, në *dhunë* (*beg'ji*). Kjo renditje u shëmbëllen shkallëve. Ai që dëshiron t'i ngjitet godinës së mirësisë, fillon nga shkalla e parë dhe duke u ngjitur do të gjendet në katin e fundit të saj. Ndërsa ai që aktualisht qëndron në godinën e mëkateve dhe dëshiron të zbresë e të heqë dorë nga ajo, duhet të zbresë gradualisht nga lart deri poshtë.

Siç e kam thënë më lart, veçoria e tretë e një mësimi të përsosur është ajo e të qenët i zbatueshëm për të gjithë. Në ajetin që po komentojmë e gjejmë edhe këtë veçori, sepse ky ajet, në njërën anë, përbën një mësim të shkëlqyer, e në anën tjetër, ai është i zbatueshëm për njerëzit e çdo shtrese dhe çdo niveli. Ai nuk mëson vetëm një moral të thjeshtë, që nuk arrin t'i shuajë etjen dikujt që kërkon nivelet më të larta, e as

nuk përmend vetëm shkallën më të lartë të virtyteve, që të dobëtit të privoheshin nga veprat e mira. Madje, ai përmend të gjitha nivelet, edhe të mirësisë edhe të ligësisë, në mënyrë që t'i nxitë të ligët të heqin dorë nga ligësitë dhe t'i ndihmojë të mirët që të përparojnë akoma më shumë në mirësi. Nëse një njeriu të zhytur në ligësi do t'i thoshit që të bëhej aq i mirë në sjellje, sa të shndërrohej në nënë për gjithë njerëzimin, do të ishte po aq e padobishme sa t'i jepnit leksionet e nivelit master, atij që ka nevojë të mësojë abetaren. Po ashtu, edhe atij që është një njeri i mirë i një shkalle të lartë, nëse i thoni që të mos ia marrë të drejtat dikujt, të mos bëjë mizori apo padrejtësi, gjithashtu është kotësi. Njeriu që është skajshmërisht i lig, mund të përmirësohet vetëm nëse së pari heq dorë nga ligësitë e mëdha, ndërsa ai që përparon drejt mirësive, atij nuk i duhen këshilla për t'u larguar nga mëkatet e mëdha, pasi ai gjendet larg atyre rrugëve. Pra, të gjitha këto veçori gjenden në këtë ajet. Ai tregon edhe rrugët e mirësive të larta, por edhe rrugët e mirësive të vogla; po ashtu, ai largon njeriun

edhe nga ligësitë e mëdha, edhe nga ato të vogla. Çdo njeri, çfarëdo natyre të ketë, jo vetëm që mund ta kuptojë këtë mësim, por edhe mund ta zbatojë atë.

Edhe një gjë që duhet të përmendim këtu është se ky ajet përmend tri nivele të ligësisë dhe tri nivele të mirësisë. Shohim që edhe në natyrë vepron ky ligj, ku çdo gjë, para se të përsoset kalon përmes gjashtë etapave. Në këtë mënyrë, ky ajet përbën gjithë planin mësimor të përsosmërisë shpirtërore, me ndjekjen e të cilit, njeriu mund të arrijë në nivelin e shtatë, ku zhvillimi i tij përsoset. Njerëzit që janë të zhytur në llumin e ligësive të kategorisë *dhunë*, duke u munduar kalojnë në baltën e *veprës së shëmtuar*. Pastaj nga atje, nëse përpiqen mund të dalin për të kaluar në pluhurat e *imoraliteteve*. Kur pastrohen edhe nga ato, do të gjenden në stepën e *drejtësisë*. Kur ecin më lart, dalin në lëndinën e *mirësisë* dhe, nëse përparojnë akoma më shumë, do të mbërrijnë në *mirësinë amënore*, në një kopsht ku rrjedhin lumenj dhe burime. Më tej shtrihet vetëm xheneti. Me

këtë kuptim Profeti Muhammed ^{s.a.} kishte thënë: “*Xheneti gjendet në këmbët e nënave*”. Edhe në ajetin që interpretojmë, *itai dhilkurba* e cila është një mirësi që bëhet me ndjenjë amënore, është quajtur shkalla më e lartë e përsosmërisë dhe njëkohësisht pozita fillestare e xhenetit. Ai që gjendet në këtë pozitë i këshillon të tjerët, duke u zhytur në dashurinë ndaj Zotit të Lartësuar aq shumë, saqë Zoti e merr si fron zemrën e tij dhe në këtë mënyrë, i dashuri dhe i dashuruari bashkohen në një lidhje të pashkëputshme.

Ky ajet recitohet në pjesën e dytë të fjalimit që mbahet çdo të premte nga predikuesi në xhami, praktikë e cila ishte nisur nga Kalifi Ameui, Umer ibni Abdul Aziz, gjë që tregon se muslimanët që në krye të herës e kuptonin rëndësinë e këtij ajeti.

(E përmbledhur nga “*Tefsir-e-Kebir*”
(Komentimi i Kuranit Famëllartë, nga
Hazret Mirza Mahmud Ahmed ^{r.a.}, Kalifi i
Dytë i Mesihut të Premtuar),
vëll. 4, f. 219-224)

Përktheu në shqip: Samad Ghori

Mos iu afroni gjërave të ndaluara!

Thënie e Profetit Muhammed ^{s.a.}

Hazret Numan bin Beshiri r.a.
rrëfen se e ka dëgjuar të Dërguarin
e Allahut s.a. duke thënë:

“Është e qartë se çka është e lejuar (*ballall*) dhe çka është e ndaluar (*haram*). Në mes të këtyre dyjave ka disa gjëra të dyshimta, për të cilat shumëkush nuk di se cilës kategori i takojnë ato. Kush ruhet prej tyre, e ruan besimin dhe nderin e tij. Kurse mund të ndodhë që ai, i cili ecë pas dyshimeve, të futet në *haram*. Shembulli i tij është si atij bariu që kullot bagëtinë e tij afër vendit të ndaluar. Vendi i ndaluar i Allahut janë ato gjëra, të cilat Ai i bëri *haram*. Dëgjoni! Ka një organ në trupin e njeriut, derisa ai është i shëndoshë, tërë trupi i tij është i shëndoshë, por, kur ai sëmuret, sëmuret i gjithë trupi i tij. Mbani mend, se ajo është zemra e njeriut”. (Sahih Muslimi)

Jeta e Muhammedit

paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të



Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed^{ra}

Jeta e Muhammedit ^{s.a.}

Autor: Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed ^{r.a.}

Përshkrim:

Kush ishte Muhammedi ^{s.a.}? Për shumë njerëz ai ishte personi më i shenjtë që kishte ekzistuar ndonjëherë, mëshirë për të gjitha botët, profet i paqes dhe si i tillë mbetet një shëmbëlltë e morale e shpirtërore për ta. Megjithatë, për shkak të gjendjes dhe sjelljes mizore të një pakice që gjithashtu, pa asnjë të drejtë, ia atribuojnë veten atij, disa njerëz i drejtohen edhe me kritika të ashpra. Por ka edhe të tillë që e vlerësojnë drejt, pasi e studiojnë jetën e tij. Profeti Muhammed ^{s.a.}, Themeluesi i fesë islame padyshim është një nga personalitetet më të diskutuara të historisë së njerëzimit.

Në këtë biografi të tij, gjurmohet gjallërisht e natyrshëm jeta e tij deri në detaje. Lexuesi do të arrijë një depërtim autentik në historinë jetësore të një njeriu, i cili si askush më parë e ndryshoi historinë e njerëzimit.

“Ndoshta përzgjedhja ime e Muhammedit për vendin e parë në listën e njerëzve më me influencë në botë, do t’u ngjallë çudi disa lexuesve, madje disa mund të ngrenë pyetje rreth kësaj, por, ai është i vetmi njeri në histori që mbeti jashtëzakonisht i suksesshëm, jo vetëm në arenën fetare, por edhe atë laike”, thotë shkrintari Michael H. Hart. (“The 100: A Ranking of the Most Influential Persons in History”, Carol Publishing Group, f. 8-9)

Për të marrë librin ju lutemi kontaktoni
në adresën e redaksisë *Vërtetësia*.

www.alislam.al

Miqësia me Zotin e Madhërishëm

**Mesihu i Premtuar dhe Imam
Mehdiu ^{a.s.} thotë:**

“Njerëzit në botë kur krijojnë miqësi të ngushtë, shpesh e përmbushin atë. Kush mund të jetë indiferent ndaj jush, pasi të keni krijuar miqësi me të! Edhe sikur të kemi lidhje të sinqertë me një vjedhës, ai nuk do të bëjë vjedhje në shtëpinë tonë. Atëherë, si është e mundur që besnikëria e Zotit të Madhërishëm të mos jetë të paktën sa ajo e vjedhësit?! Miqësia e Zotit është e tillë që nuk mund t’ia gjesh shembullin te njerëzit e kësaj bote. Madje, në miqësinë e tyre ekziston rreziku i pabesisë. Vetëm me pak

qejfmbetje, njeriu materialist bëhet gati për ta prishur atë. Por Zoti i Madhërishëm mban lidhje të forta. Ai që bën miqësi



me Zotin e Madhërishëm, Zoti i Madhërishëm e spërkat me bekimet e Tij; ia bekon shtëpinë; ia bekon rrobat; madje ia bekon edhe mbetjet e ushqimit të tij.

Në Buhari thuhet se nëpërmjet *nafileve* (veprat e mira që njeriu i bën vullnetarisht), njeriu krijon lidhje me Zotin e Madhërishëm. *Naflet* mund të jenë në fusha

të ndryshme të praktikës njerëzore. Gjithçka që bëni përveç obligimeve, hyn në veprat *nafile*. Kur njeriu përparon në *nafile*, Zoti i Madhërishëm thotë se Ai bëhet sytë e tij, përmes të cilëve ai njeri shikon; gjuha e tij, përmes së cilës ai flet. Zoti i Madhërishëm thotë: “ai që përballet me mikun Tim, le të bëhet gati të luftojë me Mua”. Ata që kanë dashuri të singertë me Zotin e Madhërishëm, bëhen të pavarur dhe sedërmëdhën. Nuk i kushtojnë aspak rëndësi kundërshtimit të njerëzve. Ndërsa, ata që u kushtojnë rëndësi krijesave, i adhurojnë. Robërit e Zotit të Madhërishëm, edhe pse janë shumë dashamirës, njëkohësisht kanë edhe ndenjën e pavarësisë. Nuk merakosen për botën. Më pas, kanë bekimin e Zotit të Madhërishëm, që bota të tërhiqet pas tyre”.

(“*Malfuzat*” vëll. 4, f. 506)



RRUGA DREJT PAQES

Marrëdhëniet e drejta midis shteteve



Fjalimi historik i Hazret Mirza Masrur Ahmedit,
Kryetar botëror i Xhematit Musliman Ahmedia

Mbajtur në Capitol Hill,
Washington D.C., ShBA,
më 27 qershor 2012

Më 27 qershor 2012, ndodhi një ngjarje historike në Capitol Hill, Uashington, D.C. Hazret Mirza Masrur Ahmedi, (Allahu e ndihmoftë fuqimisht), Kalifatul Masih V, pasardhësi i pestë i Mesihut të Premtuar ^{alejhiselam} dhe kryetari botëror i Xhematit Musliman Ahmedia u drejtua deputetëve të Kongresit, senatorëve, ambasadorëve, stafit të Shtëpisë së Bardhë dhe të Departamentit të Shtetit, kryetarëve të OJQ-ve, përfaqësuesve fetarë, profesorëve, këshilltarëve politikë, burokratëve, përfaqësuesve diplomatikë, ekspertëve të fushave të ndryshme strategjike, përfaqësuesve të Pentagonit

dhe gazetarëve të medias. Ky takim, i pari i kësaj natyre, u dha mundësi disa prej liderëve më ndikues të Shteteve të Bashkuara, përfshirë të nderuar znj. Nancy Pelosi, kryetare e grupit demokrat në Dhomën e Përfaqësuesve, për të dëgjuar drejtpërdrejtë mesazhin e Islamit për paqen botërore. Pas përfundimit të këtij evenimenti, Shkëlqesisë së tij iu mundësua një vizitë në ndërtesën e Capitol Hill. Pastaj, ai u shoqërua në Dhomën e Përfaqësuesve, ku u paraqit një rezolutë në nder të vizitës së Kalifit në Shtetet e Bashkuara. Paragrafi i parë i kësaj rezolute shpreh: “... duke i shprehur mirëseardhjen Shkëlqesisë së tij, Hazret Mirza Ma-srur



Ahmedit, Udhëheqësi shpirtëror i Xhematit Musliman Ahmedia, në Uashington, DC, dhe duke vlerësuar përkushtimin e tij për paqen botërore, drejtësinë, ndalimin e dhunës, për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, lirisë fetare dhe demokracisë...”



Senatori **Robert Casey** (US-PA) priti Shkëlqesinë e tij në Shtetet e Bashkuara dhe tha se ishte tejet i nderuar që pati mundësinë për t'u takuar me të. Ai shtoi: *“Shkëlqesia juaj! Dua t'ju falënderoj për udhëheqjen tuaj të jashtëzakonshme dhe për angazhimin tuaj për paqen, tolerancën dhe drejtësinë.”*



Kongresmeni i parë musliman, **Keith Ellison** (US MN-5) tha se Shtetet e Bashkuara janë “nderuar me pratinë

e Shkëlqesisë së tij” dhe shtoi që nën udhëheqjen e Kalifit të tij, Xhemati Musliman Ahmedia po shfaqet si *“një bekim i vërtetë për popullin Amerikan.”*



Kongresmeni **Brad Sherman** (US CA-27) tha se menjëherë pas këtij evenimenti ai do të paraqesë Rezolutën Legjislative në Dhomën e Përfaqësuesve për t'i shprehur mirëseardhjen Shkëlqesisë së tij në Shtetet e Bashkuara. Ai gjithashtu u shpreh që Kalifi është *“shëmbëlltira e tolerancës për mbarë botën.”*



Katrina Lantos Swett, kryetare e Komisionit për Lirinë Ndërkombëtare të Fesë në Shtetet e Bashkuara (US-

CIRF) tha se ajo beson se e gjithë salla është mbushur “me një bekim të veçantë dhe padyshim ky është pasqyrim i atij bekimi që Shkëlqesia e tij ka sjellë në Capitol.” Ajo gjithashtu dënoi persekutimin e vazhdueshëm të Muslimanëve Ahmedianë në vende të ndryshme.



Kongresmeni **Frank Wolf** (VA-10) i uroi mirëseardhjen Hazret Mirza Masrur Ahmedit (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) në Shtetet e Bashkuara dhe Xhemati Musliman Ahmedia është gjithmonë i gatshëm për të mbështetur të gjitha përpjekjet për të drejtat njerëzore.



Kongresmeni **Mike Honda** (CA-15) i tregoi audiencës kënaqësinë që ai përjetoi gjatë një takimi personal me

Shkëlqesinë e tij mbrëmë në xhaminë *Bejturr Rrahman*. Ai gjithashtu shprehu besimin që muslimanët ahmedianë do të mbeten të sigurt në ShBA, me qëllim që të vijojnë të promovojnë mesazhin e paqes.



Pastaj, anëtarja e kongresit, znj. **Zoe Lofgren** (D-CA) i dorëzoi Shkëlqesisë së tij, një kopje të Rezolutës së veçantë Legjislative, që ishte miratuar në nder të vizitës së tij në ShBA.



Liderja demokrate, anëtarja e kongresit znj. **Nancy Pelosi** tha se ajo është krenare që një mikpritje e tillë

ndërpartiake i është kushtuar Hazret Mirza Masrur Ahmedit (Allahu e ndihmoftë fuqimisht). Ajo gjithashtu tha se udhëheqja e Hazret Mirza Masrur Ahmedit shquhet për *“urtësinë dhe dashurinë.”* Ajo shtoi se pavarësisht nga përballja me persekutimin e ashpër, “Shkëlqesia e tij ka refuzuar të tërhiqet nga ashpërsia ose hakmarrja.”

Hazret Mirza Masrur Ahmedi (Allahu e ndihmoftë fuqimisht), kryetar botëror i Xhematit Musliman Ahmedia, mbajti fjalimin e tij kryesor në 10:40. Trasnkriptimi i këtij fjalimi historik paraqitet si vijon:

**Rruga drejt pages:
marrëdhëniet e drejta
midis shteteve**

*Fjalimi i Hazret Mirza Masrur
Ahmed (Allahu e ndihmoftë
fuqimisht) Kalifatul Mesih V,
në Capitol Hill, Washington D.C.
27 qershor 2012*



Bismil-la hirr-rrahmaninrr rrahim (Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit)

Es-selamu alejkum ua rrahmatullahi ua brakatuhu

Të nderuar miq, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ju të gjithë!

Para se të filloj, dua të përfitoj nga rasti për t’ju falënderuar të gjithë juve, që gjetët kohë për të ardhur këtu e për të më dëgjuar.

Mua më kanë kërkuar të flas rreth një çështjeje që është madhore dhe mban një spektër të gjerë temash. Ajo përfshin aspekte të ndryshme dhe prandaj nuk është e mundur

për mua që t'i mbuloj të gjitha ato brenda një kohe kaq të shkurtër. Tema që mua më është besuar të shtjelloj është: "Vendosja e paqes botërore". Sigurisht, kjo është çështja më jetësore dhe më e ngutshme me të cilën ballafaqohet bota e sotme. Megjithatë, ngaqë koha është e kufizuar, do të parashtoj shkurtimisht këndvështrimet e Islamit për vendosjen e paqes përmes marrëdhënieve të drejta dhe të barabarta midis shteteve.

Në të vërtetë, paqja dhe drejtësia janë të pandashme. Ju s'mund ta gëzoni njërën pa arritur tjetrën dhe sigurisht, këtë parim e kuptojnë të gjithë njerëzit e mençur dhe të zgjuar.

Duke lënë mënjanë ata që kanë vendosur të shkaktojnë vetëm çrregullim në botë, askush s'mund të besojë që në një shoqëri, shtet apo në gjithë botën, mund të ekzistojë kaosi apo mungesa e paqes edhe nëse aty funksionon drejtësia dhe marrëdhëniet e drejta.

Megjithatë, ne shohim që çrregullimi dhe mungesa e paqes janë dominuese në shumë vende të botës. Një anarki e tillë është e dukshme edhe së brendshmi, brenda shteteve, dhe së jashtmi për sa u përket marrëdhënieve midis shteteve të ndryshme. Ky pështjellim dhe mosmarrëveshje ekziston edhe pse të gjitha qeveritë pretendojnë se politikat e tyre janë bazuar në drejtësi dhe të gjithë deklarojnë që vendosja e paqes është objektivi i tyre kryesor. Por, në përgjithësi, nuk ka asnjë dyshim që pakënaqësia dhe ndjenja e ankthit janë në rritje, dhe po kështu edhe pështjellimi po përhapet në botë. Kjo vërteton qartazi që në këtë linjë mungojnë disa elemente në përmbushjen e kërkesave të drejtësisë. Prandaj, kemi nevojë të ngutshme për të bërë përpjekje për ta eliminuar këtë pabarazi, kudo dhe kurdo shfaqet ajo.

Për këtë arsye, duke qenë kryetar i Xhematit Musliman Ahmedia, dua të parashtoj disa këndvështrime në lidhje me nevojën e paqes si dhe për mënyrat për ta arritur atë paqe që bazohet në drejtësi.



Xhemati Musliman Ahmedia është një bashkësi plotësisht fetare. Ne besojmë me bindje të plotë që Mesihu dhe Reformatori, i cili ishte premtuar që do të vinte në këtë kohë dhe do të ndriçonte botën përmes mësimave të vërteta të Islamit, në të vërtetë ka ardhur. Ne gjithashtu besojmë që themeluesi i bashkësisë sonë, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi i Kadijanit, ishte po ky ai Mesih i Premtuar dhe Reformator, dhe prandaj ne e kemi pranuar atë. Duke iu përmbajtur porositë të tij, ne ndjekim dhe përhapim mësimet e vërteta të Islamit, bazuar në Kurandin Famëllartë. Prandaj, gjithçka që do të

them në lidhje me vendosjen e paqes si dhe me krijimin e marrëdhënieve të drejta ndërkombëtare, bazohet në mësimet e Kuranit Famëllartë.

Për sa i përket arritjes së paqes botërore, ju të gjithë vazhdimisht shprehni opinionet tuaja dhe me të vërtetë bëni përpjekje të mëdha. Intellekti dhe arsyeja juaj ju mundëson të parashtroni ide dhe plane të mëdha dhe sigurisht edhe vizionin për paqe. Prandaj, nuk është e nevojshme ta trajtoj këtë çështje nga këndvështrimi material apo politik. Për këtë arsye, siç kam thënë, do të paraqes disa këshilla




mjaft të çmuara bazuar në mësimet e Kuranit Famëlartë.

Është shumë e rëndësishme që të mbajmë mend se dija njerëzore dhe intelekti i njeriut nuk janë të përsosura, përkundrazi ato janë të kufizuara. Prandaj, duke marrë vendimet ose duke formuar mendimet, shpesh disa faktorë hynë në mendjen njerëzore dhe mund të influencojnë gjykimet dhe mund t'i prijnë njeriut që të përmbushë interesat e veta. Rrjedhimisht, kjo mund ta çojë atë drejt një rezultati dhe vendimi të padrejtë. Megjithatë, ligji i Zotit është i përkryer dhe tek Ai nuk ekzistojnë interesa të ulëta dhe masa të padrejta. Kjo sepse, Zoti dëshiron vetëm të mirën dhe mirëqenien e krijesës së Tij, prandaj

edhe ligji i Tij bazohet tërësisht në drejtësi. Ditën kur popujt e botës do të arrijnë ta njohin dhe ta kuptojnë këtë pikë vendimtare, ajo do të jetë dita kur do të vendoset baza e paqes së vërtetë dhe të përhershme. Për ndryshe, do të shohim që ndonëse janë bërë përpjekjet e pafundme për të vendosur paqen mbarëbotërore, ato akoma nuk kanë dhënë rezultatin e dëshiruar.

Pas përfundimit të Luftës I Botërore, liderët e disa shteteve të caktuara shprehën dëshirën për vendosjen e marrëdhënieve të mira miqësore në të ardhmen midis të gjitha shteteve të botës. Kështu që në përpjekje për të arritur paqen botërore, u formua “Liga e Shteteve”. Qëllimi i saj kryesor ishte të ruante

World War II Deaths



paqen botërore dhe të parandalonte shpërthimin e luftërave të reja. Fatkeqësisht, ligjet e Ligës dhe rezolutat që ajo miratoi kishin disa të meta dhe mangësi dhe kështu ato nuk mbrojtën të drejtat e të gjithë popujve apo të të gjitha kombeve në mënyrë të barabartë. Kështu vendet filluan të shkëputeshin nga Liga një nga një si pësojë e pabarazive ekzistuese, paqja e qëndrueshme nuk mundi të realizohej. Përpjekjet e Ligës dështuan dhe kjo i parapriu drejt për drejt Luftës së Dytë Botërore.

Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për shkatërrimin dhe rrënimin e

pashembullt që shkaktoi kjo luftë, ku më shumë se 75 milion njerëz humbën jetën, ku pjesa dërrmuese prej tyre ishin civilë të pafajshëm. Ajo luftë duhet të ishte më se e mjaftueshme për t'i çelur sytë botës. Kjo duhet të kishte shërbyer si mjet për të hartuar politika të mençura, të bazuara në drejtësi, të cilat do t'u siguronin të gjitha palëve të drejtat e tyre të merituar, dhe kështu të rezultonin si mjete për vendosjen e paqes në botë. Qeveritë botërore e asokohe, sigurisht u orvatën deri në një farë mase, që të ushtronin përpjekje dhe të vendosnin paqe, dhe prandaj u themelua Organizata e Ko-



mbeve të Bashkuara. Megjithatë, u bë e qartë shumë shpejt, që objektivat më qendrore dhe më madhështore që duhet të mbështesnin “Kombet e Bashkuara”, nuk mund të përmbusheshin. Sigurisht sot, disa qeveri të caktuara shpallin haptazi deklarata që vërtetojnë dështimin e saj.

Çfarë thotë Islami në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare që bazohen në drejtësi dhe që shërbejnë si mjet për vendosjen e paqes? Në suren 49, ajetin 14 të Kuranit Famëlartë, Zoti i Plotfuqishëm duke treguar që përkatësitë tona

kombëtare dhe prejardhjet tona etnike shërbejnë vetëm si një mjet identifikimi, na qartëson që ato nuk i japin apo nuk i atribuojnë askujt ndonjë epërsi.

Kështu Kurani bën të qartë se të gjithë njerëzit janë lindur të barabartë. Madje, gjatë fjalimit të tij të fundit, Profet Muhammedi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) porositi të gjithë muslimanët që të kishin parasysh se një Arab nuk gëzon asnjë lloj epërsie mbi një jo-arab dhe as një joarab nuk gëzon epërsi mbi një arab. Ai gjithashtu mësoi se një i bardhë nuk është më

Në të vërtetë, paqja dhe drejtësia janë të pandashme. Ju s'mund ta gëzoni njëriën pa arritur tjetrën dhe sigurisht, këtë parim e kuptojnë të gjithë njerëzit e mençur dhe të zgjuar.

i mirë se një njeri me ngjyrë dhe as ky i fundit nuk ka epërsi mbi një person të racës së bardhë. Kështu, ky është mësim i qartë i Islamit se njerëzit e të gjitha kombësive dhe të gjitha racave janë të barabartë. Po kështu, është bërë e qartë se të gjithë qytetarëve duhet t'u sigurohen të drejtat e barabarta, pa asnjë lloj diskriminimi apo paragjykimi. Kjo është çështja kyçe dhe parimi i artë që hedh themel për harmoninë midis grupeve dhe shteteve të ndryshme si dhe për vendosjen e paqes.

Megjithatë, ne shohim një hendek dhe ndarje midis shteteve të fuqishme dhe shteteve të dobëta. Për shembull, ne vërejmë që në Kombet e Bashkuara ekziston një dallim për disa shtete të caktuara. Kështu në Këshillin e Sigurisë, disa shtete janë

anëtare të përhershme dhe disa të tjera janë anëtare të përkohshme. Kjo ndarje ka shërbyer si një burim i brendshëm ankthi e indinjate dhe prandaj ne shpesh dëgjojmë që disa shtete të caktuara protestojnë ndaj kësaj pabarazie.


Islami mëson drejtësi dhe barazi absolute në të gjitha çështjet. Një tjetër udhëzim mjaft domethënës e gjejmë në suren 5, ajetin 3 të Kuranit Famëlartë. Në këtë ajet ai deklaron që për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave të drejtësisë, është e rëndësishme që edhe ata persona, që kalojnë çdo kufi në urrejtje e armiqësi, të gjykohen me drejtësi dhe paanësi. Kurani predikon se kudo dhe cilido që ju këshillon për të mirat dhe virtytet, ju duhet t'i pranoni ato, po ashtu kurdo e cilido ju nxit për sjellje të gabuar apo të padrejtë, ju duhet ta hidhni poshtë atë.

Një pyetje që lind natyrshëm është se cilat janë standardet e drejtësisë që kërkon Islami? Kurani Famëlartë në kapitullin 4, ajetin 136 tregon se edhe pse ju kërkohet të jepni dëshmi kundër vetes apo prindërve tuaj dhe njerëzve më të dashur, ju

duhet ta bëni këtë për të përkrahur drejtësinë dhe të vërtetën. Shtetet e fuqishme dhe të pasura, për të mbrojtur të drejtat e tyre, nuk duhet të uzurpojnë të drejtat e shteteve të varfra dhe të pafuqishme e as nuk duhet të sillen padrejtësisht me këto vende. Ndërsa në anën tjetër, shtetet e varfra dhe më pak të fuqishme nuk duhet t'u sjellin dëme shteteve të pasura dhe të fuqishme sa herë që u jepet mundësia. Përkundrazi, të dyja palët duhet të orvaten t'i përmbahen plotësisht parimeve të drejtësisë sepse kjo në të vërtetë, është një çështje me rëndësi vendimtare në lidhje me ruajtjen e marrëdhënieve miqësore midis shteteve.

Një tjetër kusht për vendosjen e paqes midis shteteve, përmendet në suren 15, ajetin 89 të Kuranit Famëlartë, aty ku ai shprehet që asnjë grup nuk duhet të vështrojë resurset dhe pasuritë e të tjerëve me lakmi. Po kështu asnjë shtet nuk duhet të synojë të përvetësojë padrejtësisht apo të rrëmbejë resurset e shtetit tjetër me pretekstin se përpiqet ta ndihmojë apo ta mbështesë atë. Prandaj, duke përdorur dhënien e ekspertizës

teknike si një parakusht, qeveritë nuk duhet të shfrytëzojnë situatën për të nënshkruar marrëveshje apo pakte jo të barabarta. Në të njëjtën mënyrë, me pretekstin e dhënies së ekspertizës apo mbështetjes, qeveritë nuk duhet të synojnë të rrëmbejnë me dredhi burimet natyrore apo pasuritë e shteteve në zhvillim. Aty ku ka nevojë që qytetarët apo qeveritë të trajnohen për mënyrën e shfrytëzimit të burimeve natyrore, atëherë kjo duhet realizuar. Shtetet dhe qeveritë gjithmonë duhet të synojnë për t'i shërbyer dhe përkrahur ato shtete që janë në nevojë. Megjithatë, këto shërbime nuk duhen ofruar me qëllimin e përmbushjes së përfitimeve kombëtare apo politike ose si një mjet për të realizuar interesat e ligëta. Ne shohim se gjatë gjashtë apo shtatë dekadave të fundit, Organizata e Kombeve të Bashkuara ka hartuar programe dhe ka themeluar fondacione të shumta që synojnë të ndihmojnë vende të varfra në zhvillim e progres. Për ta arritur këtë qëllim, ato kanë eksploruar burime natyrore të vendeve që janë në zhvillim. Megjithatë, pavarësisht



përpjekjeve të tyre, asnjëri nga shtetet e varfra nuk ka arritur nivelin e shteteve të zhvilluara. Sigurisht, një ndër shkaqet e kësaj prapambetjeje është korrupsioni i gjithanshëm në shumë ndër qeveritë e këtyre vendeve të varfra. Megjithatë, dua të shpreh keqardhjen time që shtetet e zhvilluara, vazhdojnë të bashkëpunojnë me qeveri të tilla vetëm për të shtyrë përpara interesat e tyre vetjake. Pra, marrëveshjet tregtare, ndihmat ndërkombëtare dhe kontratat e biznesit vazhdojnë të kryhen. Si rezultat, pakënaqësia dhe zemërimi i shtresës së varfër dhe

të segmenteve të tjera të privuara të shoqërisë vazhdojnë të rriten në këto vende dhe kjo ka nxitur kryengritje e trazira të brendshme. Popujt e varfër të vendeve në zhvillim janë zhgënjyer aq shumë saqë kanë dalë jo vetëm kundër liderëve të tyre por edhe kundër fuqive perëndimore. Kjo situatë është shfrytëzuar nga grupet ekstremiste, të cilat kanë përfituar nga dëshpërimet e popullit, dhe kështu kanë arritur të nxisin njerëzit për t'iu bashkuar grupeve të tyre dhe për të mbështetur ideologjinë e tyre plotë urrejtje. Rezultati përfundimtar i gjithë kësaj situatë është se pagja



e botës po shkatërrohet. Kështu, Islami na tërheq vëmendje ndaj mjeteve që duhen për vendosjen e paqes. Ai kërkon drejtësinë absolute. Ai kërkon që gjithmonë të paraqiten vetëm dëshmi të vërteta. Ai kërkon që vështrimet tona të mos hidhen lakmueshëm ndaj pasurive të të tjerëve. Ai gjithashtu kërkon që vendet e zhvilluara të heqin dorë nga interesat e tyre vetjake, përkundrazi të përkrahin dhe t'u vijnë në ndihmë shteteve të varfra dhe më pak të zhvilluara me një qëndrim të sinqertë dhe frymë altruiste. Nëse të gjithë këta faktorë respektohen, vetëm

atëherë mund të arrihet paqja.

Mbani mend, aty ku bëhet padrejtësi, kurrë nuk mund të ketë paqe. Po kështu, nëse një shtet shkel të gjithë kufijtë e hidhet në sulm ndaj shtetit tjetër dhe synon të zaptojë padrejtësisht të gjitha resurset e tij, atëherë shtetet e tjera domosdoshmërisht duhet të marrin masat për të ndaluar padrejtësi të tillë. Por, edhe ato duhet të veprojnë gjithmonë me drejtësi.

Rrethanat të cilat sipas mësimave të Islamit, detyrojnë për të vepruar,

*Mbani mend, aty ku bëhet
padrejtësi, kurrë nuk mund të
ketë paqe. Po kështu, nëse një
shtet shkel të gjithë kufijtë e
bidhet në sulm ndaj shtetit tjetër
dhe synon të zaptojë padrejtësisht
të gjitha resurset e tij, atëherë
shtetet e tjera domosdoshmërisht
dubet të marrin masat për
të ndaluar padrejtësi të tillë.
Por, edhe ato duhet të veprojnë
gjithmonë me drejtësi.*

janë përshkruar imtësisht në sure
49, ajet 10 të Kuranit Famëlartë:
Ai mëson që nëse dy shtete kanë
mosmarrëveshje apo konflikte midis
tyre dhe kjo situatë i çon ato deri në
luftë, atëherë shtetet e tjera duhet
t'i drejtojnë ato në mënyrë rigoroze
ndaj dialogut dhe diplomacisë, me
qëllim që ato të mund të arrijnë
një marrëveshje dhe të pajtohen
në bazë të një ujdje të hartuar pas
bisedimeve midis tyre. Megjithatë,
nëse njëri prej tyre nuk pranon
kushtet e pajtimit dhe i shpall luftë
shtetit tjetër, atëherë shtetet e tjera

duhet të bashkohen dhe të luftojnë
për të ndaluar agresorin. Kur të
mposhtet shteti agresor dhe të
pajtohet për bisedime të ndërsjella,
atëherë të gjitha shtetet duhet të
bashkëpunojnë për të realizuar një
marrëveshje midis tyre, e cila mund
t'u prijë drejt paqes së qëndrueshme
dhe pajtimit të ndërsjellë. Nuk duhen
imponuar sanksione të rrepta dhe
të padrejta, që mund të gjymtojnë
cilindo shtet, sepse në planin
afatgjatë, kjo çon drejt pakënaqësisë
e cila acarohet dhe përhapet me
shpejtësi. Rezultati i gjithë kësaj
pakënaqësie do të jetë vetëm më
shumë çrregullime. Në rrethana të
tilla, nëse një shtet i tretë ndërmjetës
mundohet t'i pajtojë të dyja palët
në konflikt, ai duhet të veprojë me
sinqeritet dhe paanshmëri të plotë.
Kjo paanshmëri duhet të mbetet
kësisoj edhe nëse njëra palë shprehet
kundër tij. Pra, shteti ndërmjetës
nuk duhet të shfaqë zemërimin e tij
në rrethana të tilla e as nuk duhet
të kërkojë hakmarrje apo ndonjë
veprim tjetër në mënyrë të padrejtë.
Të gjitha palëve të interesuara,
u duhen siguruar të drejtat që u
takojnë atyre.

Pra, për të përmbushur kërkesat e drejtësisë, është e domosdoshme që të gjitha shtetet që janë pjesëmarrëse në negociatat për një marrëveshje, nuk duhet të synojnë përmbushjen e interesave të tyre personale, as të tentojnë të nxjerrin përfitime të padrejta nga njëra prej palëve. Po kështu, ato nuk duhet të ndërhyjnë padrejtësisht ose të mbajnë nën presion njëren prej palëve në mënyrë abuzive. Resurset natyrore të një shteti absolutisht nuk duhen zhvatur. Sanksionet e panevojshme dhe të padrejta nuk duhen vendosur mbi shtete të tilla, sepse kjo mënyrë jo vetëm që nuk është e drejtë, por nuk mund të shërbejë kurrën e kurrës si një mjet për të përmirësuar marrëdhëniet midis shteteve.

Për shkak të kohës së kufizuar, unë kam përmendur përciptas vetëm disa pika. Për ta përmbledhur: nëse ne duam që paqja të mbizotërojë, atëherë ne doemos duhet të heqim dorë nga interesat tona personale apo kombëtare për dobitë më të mëdha dhe ne gjithashtu duhet të themelojmë marrëdhënie të ndërsjella bazuar plotësisht mbi drejtësinë. Në të kundërt, siç ju të

gjithë jeni në dijeni se për shkak të pranisë së aleancave dhe blloqeve politike, nuk mund të themi që trazirat dhe çrregullimet nuk do të përhapen në botë. Një situatë e tillë rrjedhimisht do t'i paraprijë shkatërrimit të jashtëzakonshëm. Pasojat e këtij shkatërrimi të tillë dhe të këtyre luftërave sigurisht do të mbeten për shumë gjenerata. Andaj, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si fuqia më e madhe e botës, duhet të luajë rolin e saj duke vepruar me drejtësi të vërtetë dhe qëllime të sinqerta, siç kam përmendur përpara. Nëse ju arrini ta realizoni këtë, atëherë bota gjithmonë do t'ju kujtojë me admirim madhështor për përpjekjet tuaja të mëdha. Lutja ime është që dëshira ime të shndërrohet në realitet.

Shumë faleminderit!

<http://www.reviewofreligions.org/download/RR201209.pdf>

Përktheu në shqip: Shahid Ahmad

Profeti Muhammed^{s.a.} në sytë e intelektualëve



Profeti Muhammed ^{s.a.} lindi në Mekë në vitin 571. Ai ishte pasardhës i drejtpërdrejtë i profetit Ibrahim ^{alejhiselam}, nga familja e Ismailit ^{alejhiselam}. Mbeti jetim në një moshë shumë të vogël dhe u kujdes nga xhaxhai i tij. Punoi si tregtar dhe u martua në moshën 25 vjeçare. Bëri një jetë modeste dhe të thjeshtë. Ishte shquar për fisnikërinë dhe ndershmërinë e tij, madje atë e quanin me titullin el-emin d.m.th. i besueshëm. Duke parë gjendjen e mjeruar të popullit të tij, padrejtësinë, gjakderdhjen, imoralitetin dhe mizorinë ndaj të dobëtëve, Muhammedi ^{s.a.} shpesh shkonte në një shpellë afër qytetit, ku kalonte një kohë të gjatë duke medituar dhe adhuruar Zotin. Këtu në moshën 40 vjeçare, ai mori shpalljen e parë nga Zoti, përmes engjëllit Xhibril, mesazh të cilin duhet t'ua përcillte gjithë njerëzve. Muhammedi ^{s.a.} u angazhua në predikimin e kësaj feje, e cila u quajt Islam, në këshillimin e bashkëkombësve të tij që t'i besonin Zotit të Vetëm e të Plotfuqishëm, duke u larguar nga çdolloj idhujtarie. Për të shmangur çdolloj atributi hyjnor që mund t'i jepej nga njerëzit,

veten e quante rob dhe të Dërguar të Zotit.

Ai dhe ndjekësit e tij të parë u dhunuan dhe u persekutuan vetëm për shkak të besimit në një Zot. Kur përndjekja arriti në kulmin e saj, Profeti ^{s.a.}, bashkë me muslimanët e tjerë, u detyruan të shpërnguleshin në një qytet tjetër, Medine. Banorët e Medinës pranuan thirrjen e tij dhe e zgjodhën si prijës të tyre. Por, mekasit nuk e lanë të qetë edhe në Medinë. Për të shfarosur Islamin dhe për të vrarë muslimanët, ata sulmuan Medinën disa herë. Muslimanët, ndonëse shumë herë më të pakët në numër, arritën t'i sprapsin agresorët. Kur triumfoi mbi Mekën, Profeti ^{s.} ^{a.v.s.} fali të gjithë kundërshtarët, të cilët, për vite me radhë, kishin ushtruar dhunë dhe shtypje të egër ndaj tij, të afërmve dhe ndjekësve të tij.

Për muslimanët, Profeti Muhammed ^{s.a.} është shembulli më i përsosur për t'u ndjekur. Ai është vullë e të gjithë profetëve. Në qenien e tij, mishërohen shfaqjet më fisnike të karakterit njerëzor, si

prijës, mësues, bashkëshort, prind, shok, etj. Sjellja dhe veprat e tij janë udhërrëfyese edhe sot për miliona njerëz anembanë botës.

Pavarësisht nga vetitë më fisnike të jetës së tij, keqdashësit gjatë shekujve të kryqëzatave, kanë drejtuar shpifjet nga më të ulëta ndaj tij. Koha ka përparuar dukshëm në përforcimin e lirisë dhe tolerancës fetare dhe shkrimtarët perëndimorë kanë shfaqur një ndryshim rrënjësor në qëndrimin e tyre ndaj jetës së Profetit Muhammed ^{s.a.}. Megjithatë, kohët e fundit, në emër të lirisë së shprehjes, nuk janë të pakta, përçapjet për të njollosur karakterin e shkëlqyer të këtij Profeti madhor ^{s.a.}.

Por, pavarësisht nga mjegullnaja shekullore rreth realitetit të Profetit Muhammed ^{s.a.}, në çdo kohë kanë qenë shkrimtarë të paanshëm, të cilët janë përpjekur të çjerrin perden e injorancës dhe të pasqyrojnë aspektet rrezatuese të këtij pishtari të paqes.

Në vijim, do t'ju paraqesim disa nga shkrimet e mendjeve më të ndriçuara të kohës sonë, që hedhin

dritë mbi jetën e Muhammedit ^{s.} ^{a.v.s.}, për të pasur një vështrim më të drejtë, të logjikshëm dhe objektiv rreth profetizmit të tij.

.....



John William Draper në librin
e tij shkruan:

“Katër vjet pas vdekjes së Justinianit, në vitin 569, në Mekë lindi një person, i cili provoi ndikimin më të madh mbi racën njerëzore, ai ishte Muhammedi ^{s.a.} të cilit Evropianët i ngjitën nofken “gënjeshhtar”... Te Muhammedi gërshtoheshin ato veti, që vendosën për fatin e shumë perandorive. Ai ishte një ushtar predikues, shprehës në foltore dhe në fushë betejë dilte si trim. I gjithë thelbi i fesë së tij ishte vetëm kaq: “Zoti është një”.... Duke

pohuar këtë realitet të përvetshëm, ai nuk u përfshi në metafizika të kota, por, e ngarkoi veten në përmirësimin e gjendjes shoqërore të popullit të tij, përmes rregullave që kujdeseshin për dëlirësinë personale, vetëpërmbajtje, agjërime dhe lutje. Karshi të gjitha punëve të tjera, ai i dha epërsi lëmoshës dhe bamirësisë.”

*[A History of the Intellectual Development
of Europe, NY, f.244,1863]*

.....



Orientalisti i njohur **William Montgomery Watt** shkruan:

“Sa më shumë të përsiatësh Muhammedin dhe zanafillën e Islamit, aq më shumë mahnitesh duke parë përmasat e arritjeve të tij. Rrethanat i dhanë një mundësi

që u jepet shumë pak personave, sikur ai ishte njeriu më i denjë për atë kohë. Po t’i mungonin cilësitë si largpamësia, të qenit burrë shteti, mbështetja tek Zoti dhe besimi i palëkundur që Zoti e kishte dërguar atë, atëherë një kapitull i rëndësishëm i historisë njerëzore do të mbetej i pashkruar. Unë shpresoj se ky studim mbi jetën e tij, mund të kontribuojë për të vlerësuar njërën prej bijve më të shkëlqyer të Adamit.”

*[Muhammad at Madina, Oxford
University Press, f. 335, 1981]*

.....



Historiani i famshëm **Reverend Bosworth Smith** shkruan:

“Ai ishte edhe kryetar i shtetit, edhe udhëheqës i fesë. Personaliteti i Papës dhe i Çezarit mishëroheshin

në një qenie të vetme. Ai ishte Papa, por pa pretendime dhe qe Çezari, por i lartë nga salltaneti dhe legjioni i tij: pa ushtri, pa truproja, pa kështjellë, pa të ardhura të caktuara vjetore. Nëse dikush me të drejtë do të pohonte që sundoi me të drejtën hyjnore, ai është Muhammedi, sepse gëzoi të gjitha fuqitë, pa pasur mjete të nevojshme dhe pa asnjë përkrahje.”

[*Mohammad and Mohammadanism*, Elder & Co., Londër. f. 235, 1876]

“Askush nuk mund ta arrijë atë, që realizoi Muhammedi duke pasur besim të patundur në realitet dhe në mirësinë e qëllimit të tij [ai kishte bindje të plotë në misionin, thirrjen e tij dhe besimin që vinte nga Zoti dhe kështu u hodhën themelet e një revolucioni] ... Çdo ngjarje e jetës së tij vërteton se ai ishte një person i vërtetë, realist dhe entuziast, i cili dalëngadalë, duke duruar të gjitha mundimet, orvatet ta arrijë të vërtetën”

[si më parë, f. 127]

.....



Washington Irving shkruan:

“Fitoret e tij ushtarake nuk i ngjallën as krenari, as mendjemadhësi, as salltanet e as madhështi të jashtme. Po të kishte synuar interesat personale në këto triumfe, atëherë ai sigurisht do të mbante këto pasoja. Edhe në kulmin e fuqisë, ai ruajti atë thjeshtësi në sjelljen dhe shfaqjen e tij, që kishte në kohën e vuajtjeve. Madje, jo vetëm që nuk i pëlqente madhështia mbretërore, por, shprehte mospëlqimin e tij, kur i thureshin lavdërime të panevojshme.”

[*The Life of Mahomet*, Bernard Tauchnitz, Leipzig. f. 272-3, 1850]

.....



Orientalisti i njohur **Sir William Muir**, ndonëse është shprehur mjaft kundër Islamit, shkruan:

“I përkryer dhe i plotë në të gjitha veprimet e tij, çdo detyrë që mori përsipër, e çoi deri në fund. Kjo veti dominonte edhe në raportet shoqërore. Nëse bisedonte me dikë, nuk i kthehej pjesërisht, por kthente fytyrën dhe gjithë trupin nga ai. Kur i jepte dorën dikujt, nuk qe i pari për ta tërhequr. Kur bisedonte me ndonjë të panjohur, nuk e ndërpriste bisedën vetë, e as nuk i tregohej i pavëmendshëm. Një thjeshtësi fisnike përfshinte jetën e tij. Kishte zakon që çdo punë ta bënte vetë. Nëse i jepte lëmoshë lypësit, i jepte me dorën e vet. Ndihamonte gratë e tij në punët e shtëpisë. Përvullësia, dashamirësia, durimi, vetëmohimi dhe bujaria ishin aspektet më të

spikatura të sjelljes së tij, dhe me anë të tyre ai fitoi dashurinë e të gjithëve.”

[*Life of Muhammad*, vëll. IV, Smith, Elder and Co., Londër, f. 303-307, 1861]

“Një argument i fortë për singëritetin e Muhammedit është që muslimanët e parë ishin miqtë e ngushtë dhe pjesëtarët e familjes së tij, të cilët, duke qenë të njohur me jetën e tij personale, nuk mund të mos zbulonin mospërputhje dhe shtrembëri që pak a shumë gjenden gjithmonë në punët e jashtme të një mashtruesi dhe në sjelljen e tij brenda familjes.”

[si më parë, f. 97-8]

.....



Sir Thomas Carlyle shkruan:

“Hipoteza jonë e tanishme rreth Muhammedit, që ai ishte komplotist trillues, mishërim të pavërtetës,

ndërsa feja e tij ishte një akullnajë e budallallëkut dhe marrëzisë, sa vjen e bëhet më e papranueshme. Shpifjet dhe trillimet që kundërshtarët i ngjitën këtij profeti, sot na turpërojnë vetëm ne,... sigurisht ka ardhur koha që të çlirohemi prej tyre. Fjalët e këtij njeriu janë udhërrëfyese për 180 milionë njerëz përgjatë këtyre dymbëdhjetë shekujve. ... Aq shumë njerëz që u besojnë fjalëve të Muhammedit në këtë kohë, nuk i besojnë askujt tjetër.”

[*On Heroes, Hero-Worship & the Heroic in History*, NY, f. 47, 1846]

.....



Filozofi francez **Alphonse de Lamartine** shprehet:

“Në qoftë se madhështia e qëllimit, ngushtësia e mjeteve dhe pafundësia e rezultateve të arritura, do të ishin

tri kritere për të matur gjeninë njerëzore, atëherë kush do të guxonte të përqaste njerëzit më të mëdhenj të kohëve moderne me figurën e Muhammedit? As më të shquarit prej tyre nuk arritën veçse të ngrinin ca ushtri, ligje, perandori e themelonin autoritete fizike të pushtimit, disa prej të cilave u gremisën para syve të tyre. Muhammedi reformoi dhe rimodeloi ushtritë, ligjet, perandoritë, kombet dhe dinastitë me miliona njerëz në një të tretën e botës. Aq më tepër ai ndryshoi dhe ripërtëriu faltoret, ... fetë, dogmat, ideologjitë dhe shpirtrat. Baza e Muhammedit ishte një libër, çdo fjalë e të cilit u bë ligj, duke formuar një kombësi shpirtërore që përfshin popujt e çdo gjuhe dhe race.”

[*History of Turkey*, D. Appleton & Co., NY, f.154, 1855]

.....



Michael H. Hart thotë:

“Ndoshta përzgjedhja ime e Muhammedit për vendin e parë të njerëzve më me influencë në botë, do t’u ngjallë çudi disa lexuesve, madje disa mund të ngrenë pyetje rreth kësaj, por, ai është i vetmi njeri në histori që mbeti jashtëzakonisht i suksesshëm, jo vetëm në arenën fetare, por edhe laike.”

[*The 100: A Ranking of the Most Influential Persons in History*, Carol publishing group., f. 8-9]

.....



Shkrimtari Stanley Lane Poole,
shkruan:

“Ai e fali fisin Kurejsh për të gjitha vitet e hidhërimit dhe për përbuzjet mizore me të cilat ata e kishin legëndisur atë. Ai shpalli amnisti të përgjithshme për të gjithë banorët e Mekës... e tillë ishte ardhja e Muhammedit në qytetin e tij të lindjes. Duke shqyrtuar të gjitha kronikat e pushtimit, nuk ka asnjë hyrje triumfuese, që mund t’i përqaset kësaj.”

[*Speeches and Table Talk of the Prophet Muhammad*, Macmillan & Co., Londër, f. xlv, 1882]

.....

Filozofi francez **Alphonse de Lamartine** shkruan:

“Muhammedi ishte filozof, orator, profet, ligjbërës, luftëtar, triumfues i mendimeve, ripërtëritës i mësimëve të arsyeshme, themelues i dhjetëra pushteteve tokësore dhe i një sundimi shpirtëror. Mund të përcaktojmë çfarëdo kriteri për të vlerësuar madhështinë njerëzore, por vallë a ekzistua ndëri më i madh se Muhammedi?”

[Alphonse de Lamartine, History of Turkey, D. Appleton & Co., NY, f.154, 1855]



Mahatma Gandhi, në një shkrim të tij, shprehet:

“Unë desha të mësoja më të mirën e jetës së atij personi, i cili gëzon sot ndikim të padiskutueshëm mbi zemrat e miliona njerëzve. Jam i bindur më shumë se kurrë që nuk ishte shpata, që kishte fituar një status

të veçantë në Islam, ... por, ishin pikërisht thjeshtësia e thekshme, përvullësia e skajshme e Profetit, përkujdesja për përmbushjen e premtimeve, dhembshuria e madhe për miqtë dhe ndjekësit e tij, guximi dhe trimëria e tij, besimi i palëkundur te Zoti dhe te misioni i tij, ishin këto virtyte, dhe jo shpata, që përmbushën gjithçka para tyre dhe kapërcyen çdo vështirësi. Kur mbarova së lexuari vëllimin e dytë (të një libri rreth jetës së Profetit) u trishtova pamasë, sepse nuk kisha më për të lexuar nga ajo jetë e shkëlqyer.”

[Young India, 23/09/1924]

.....



Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia
Hazret **Mirza Ghulam Ahmed**^{a.s.} duke përshkruar
statusin e Profetit Muhammed^{s.a.} shkruan:

“Ajo dritë e shkallës së lartë që iu dha njeriut, domethënë njeriut të përsosur, nuk ishte as në engjëj, as në yje, as në hënë e as në diell, ajo nuk ishte as në thellësitë e oqeaneve apo të lumenjve; ajo nuk ishte as në rubin, as në smerald, as në safir e as në margaritar. Pra, ajo nuk gjendej në asnjë gjë të tokës apo të qiellit, por ishte vetëm te njeriu, domethënë te njeriu i përsosur, shëmbëlltyra më e plotë, më e përkryer, më e lartë

dhe më madhore e saj është Prijësi dhe Udhëheqësi ynë, Udhëheqësi i profetëve, Udhëheqësi i të gjithë njerëzve, i zgjedhuri Muhammed^{s.a.} Pra, ajo dritë i është dhënë atij, po ashtu, sipas pozitës, u është dhënë të gjithë atyre që kanë të njëjtën ngjyrë, domethënë atyre, që i ngjajnë atij”.

[*Aina Kamalate Islam*, Rruhani Khezain,
vëll. V, f. 160-161]

.....



Kisha e Varrit të Shenjtë, gjithashtu qubet Bazilika e Varrit të Shenjtë, që gjendet në lagjen e krishterë në qytetin e vjetër të Jerusalemit.



LIRIA FETARE

e Hazret Omerit ^{r.a.},

Kalif i Dytë i Profetit Muhammed ^{s.a.}



Epigraf:

**“Nuk ka dhunë në fe.
Tashmë është e dalluar e
drejta nga e shtrembra. Ai
që kundërshton shejtanin
dhe beson në Allah, ka
kapur lidhjen më të fortë që
nuk këputet kurrë. Allahu
dëgjon shumë dhe është i
Gjithëdijshëm.”**

(Kurani Famëlartë 2:257)

Kur Profeti Muhammed s.a. solli besimin monoteist, atë të Një Zoti të Vetëm, në një shoqëri politeiste, mekasit e kundërshtuan ashpër dhe e përndoqën atë dhe ndjekësit e tij për 13 vjet me radhë. Profeti u detyrua të mërgonte në Medinë, por mekasit nuk e lanë dhe e sulmuan edhe Medinën. Ishin këto rrethanat kur zbritën këto vargje të Kuranit:

“Atyre që janë sulmuar, u lejohet (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi. Në të vërtetë Allahu



Kisha e Varrit të Shenjtë, mbrapa së cilës shihet minarja katrore e xhamisë së Hazret Omerit.

është i Fuqishëm që t'i ndihmojë ata, që janë dëbuar nga shtëpitë e tyre padrejtësisht, vetëm sepse thanë: “Zoti ynë është Allahu.” Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Vërtetë, Allahu e ndihmon atë që e ndihmon Allahun. Allahu është vërtetë i Fortë dhe i Plotfuqishëm.”

(Kurani Famëlartë 22:40-41)

Kur Jerusalemi ra në duar të muslimanëve, kjo kishë nuk pati ndonjë fat tragjik, ndryshe nga xhamia e Kordobasë apo Bazilika e Shën Sofisë. Kjo për shkak të bujarisë, urtësisë dhe lirisë fetare të një njeriu, të Omerit^{r.a.}, i cili atëherë ishte Kalifi i Dytë i Profetit Muhammed^{s.a.}

Duke përmendur kishat dhe sinagogat, para xhamisë, kjo shpallje hyjnore po vendoste gurthemelin më të fuqishëm të lirisë fetare dhe të mbrojtjes së saj për mbarë njerëzimin. Këto ajete janë zbritur afërsisht në vitin 624, të cilat janë praktikuar nga vetë Profeti Muhammed s.a. në gadishullin arab dhe modeli i tij do t'i bënte edhe Kalifët e tij të praktikonin në të njëjtën mënyrë. Një shembull të vendosjes së lirisë fetare, në zbatim të porosisë së shenjtë që përmendet në ajetet e sipërshënuara, shohim në kohën kur muslimanët triumfojnë mbi Jerusalemin.

Siç dihet që në Jerusalem ndodhet

Kisha e Varrit të Shenjtë, vendi ku Jezusi ishte vënë në kryq dhe më pas ishte mbajtur trupi i tij pas kryqëzimit. Padyshim, kjo vlerë historike e saj, e bën këtë kishë një ndër vendet më të shenjta të krishterimit. Por, kur Jerusalemi ra në duar të muslimanëve, kjo kishë nuk pati ndonjë fat tragjik, ndryshe nga xhamia e Kordobasë apo Bazilika e Shën Sofisë. Kjo për shkak të bujarisë, urtësisë dhe lirisë fetare të një njeriu, të Omerit r.a., i cili atëherë ishte Kalifi i Dytë i Profetit Muhammed s.a. dhe që kishte jetuar për vite shumë afër Profetit s.a..

Për shkak të ofensivave nga kolonitë

*Ai deshi që të krishterët ta kishin lirinë
e tyre fetare dhe vendin e tyre të shenjtë.
Andaj, preferoi të falte namazin përjashta,
te shkallët, ku shekuj më vonë u ndërtua një
xhami, e quajtur Xhamia e Omerit.*

bizantine, ushtria muslimane marshoi drejt Jerusalemit dhe arriti ta rrethonte. Qyteti i shenjtë i ra në dorë në vitin 638, pas një rrethimi relativisht pa gjakderdhje. Muslimanët morën kontrollin e Jerusalemit nga bizantinët në shkurt të vitit 638. Patriarku Sofronius (Patriarch Sophronius) ia dorëzoi qytetin Hazret Omerit personalisht. Gjatë kohës kur Patriarku po i tregonte Hazret Omerit Bazilikën e Varrit të Shenjtë, erdhi vakti i namazit. Kalifit të Islamit iu siguria një vend për ta kryer faljen muslimane, por ai e refuzoi. Ai e dinte që, duke qenë Kalif i Profetit, po të falte namazin në atë kishë, në

të ardhmen ndokush tjetër do ta kthente kishën në xhami. Ai deshi që të krishterët ta kishin lirinë e tyre fetare dhe vendin e tyre të shenjtë. Andaj, preferoi të falte namazin përjashta, te shkallët, ku shekuj më vonë u ndërtua një xhami, e quajtur Xhamia e Omerit. Me gjestin e tij, Hazret Omeri r.a. e mbrojti praninë e kishës kryesore në vendin e saj. Jerusalemi mbeti në qeverisjen muslimane nga viti 638 deri në krijimin e shtetit Izrael në vitin 1948, duke përjashtuar periudhën 80-vjeçare gjatë Kryqëzatës së parë e të tretë.

Samad Ghori

ÇELËSI I PAQES - BASHKIMI GLOBAL

*Fjalimi historik nga Hazret Mirza Masroor Ahmedi Allahu e ndihmoftë
fuqimisht, Kalifatul Masih V, udhëbëgës botëror i Xhematit Musliman
Ahmedia, në Parlamentin Europian, Bruksel, Belgjikë*



Hyrje

Hazret Mirza Masroor Ahmedi ^{Allahu e ndihmofte fuqimisht}, udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia, dhe Kalifi V (pasardhës i Mesihut të Premtuar ^{alejhiselam}), bëri vizitën e tij të parë në Parlamentin Europian në Bruksel më 3 dhe 4 dhjetor 2012, gjatë së cilës, ai mbajti një fjalim historik para një auditori të gjerë me 350 të ftuar duke përfaqësuar 30 shtete. Ky eveniment ishte organizuar nga grupi i sapothemeluar ndërpartiak europian *"Friends of Ahmadiyya Muslims"* (Miqte e Muslimanëve Ahmedianë), i kryesuar nga dr. Charles Tannock deputet në Parlamentin Europian. Ky grup ndërpartiak europian përbëhet nga deputetët në Parlamentin Europian dhe është themeluar për të promovuar Xhematin Musliman Ahmedia në Parlamentin Europian si dhe për të **mbrojtur** interesat e tyre në Europë dhe në botë. Gjatë vizitës, Hazret Mirza Masroor Ahmedi ^{Allahu e ndihmofte fuqimisht} është takuar gjithashtu me deputetë dhe delegatë. Disa prej tyre vijnë si më poshtë:





Dr. Charles Tannock, Deputeti i Parlamentit Europian (Britania) [anëtar i Komitetit për Çështjet e Jashtme në Parlamentin Europian, anëtar i nën-komitetit për të Drejtat e Njeriut, z/v kryetar i delegacionit parlamentar për marrëdhëniet me asamblenë e NATO-s dhe kryetar i grupit “Miq të Muslimanëve Ahmedianë” në Parlamentin Europian] Hazret Mirza Masrur Ahmedi ngrii çështjen e persekutimit të Muslimanëve Ahmedianë në Pakistan. Shkëlqesia e tij tha se çdo muaj Muslimanët Ahmedianë po martirizohen brutalisht në Pakistan.

Charles Tannock, (MEP) tha se ai do të vijojë të mbështesë Xhematin Musliman Ahmedia në çdo mënyrë të mundshme. Ai shtoi se paradite ishte takuar me Ministren e Punëve të Jashtme të Pakistanit, dhe gjatë takimit ai ia shtroi çështjen e persekutimit, me të cilin përballet Xhemati Musliman Ahmedia në Pakistan. Shkëlqesia e tij nënvizoi parimin kryesor që njerëzit gjithmonë duhet të jenë të gatshëm për t'u ardhur në ndihmë atyre, që po lëngojnë në botë.



Tunne Kelam MEP (Estonia)

[Anëtar i Komitetit për Punët e Jashtme të Parlamentit European, të nën-komitetit për Sigurinë & Mbrojtjen dhe zëvendëskryetar i grupit “miqtë e muslimanëve ahmedianë” në Parlamentin European]. Ai u shpreh se vizita e Hazret Mirza Masrur Ahmedit në Parlamentin European “ka një rëndësi të veçantë sepse ajo do të pasurojë mirëkuptimin tonë.” Tunne Kelam MEP i bëri të ditur Shkëlqesisë së tij për situatat politike në vendin e tij, Estoni. Kalifi shprehu kënaqësinë e tij që

***Qëllimet kryesore
dhe gjithëpërfshirëse
duhet të jenë gjithmonë
reformimi, pajtimi dhe
vendosja e paqes së
qëndrueshme.***

Estonia ka kapërcyer vështirësitë e së kaluarës, dhe tashmë gëzon një qeveri të qëndrueshme.

Claude Moraes MEP (Britania)

[zëvendëskryetar i delegacionit



për Marrëdhëniet me Gadishullin Arab, anëtar i Komitetit për lirinë shoqërore, drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, nënkryetar i partisë Laburiste në Parlamentin Europian dhe nënkryetar i grupit “miqtë e muslimanëve ahmedianë” në Parlamentin Europian. Claude Moraes MEP, shtroi një drekë në nderim të Hazret Mirza Masrur Ahmedit. Ai gjithashtu u shpreh që udhëheqësi i Xhematit Musliman Ahmedia është “një lider i jashtëzakonshëm, i cili dallohet nga liderët e tjerë fetarë.”

Ai gjithashtu tregoi që Shkëlqesia e tij është mirëpritur veçanërisht në Parlamentin Europian sepse ai vjen me mesazhin e paqes dhe tolerancës.

Barbara Lochbihler MEP (Gjermani) [Kryetare e nën-komitetit për të Drejtat e Njeriut në Parlamentin Europian]. Ajo shprehu shqetësimin e saj për persekutimin e muslimanëve Ahmedianë në mbarë botën dhe i siguroi Kalifit se ajo do t’i përcjellë mesazhin e tij edhe anëtarëve të tjerë të nën-komitetit.



Jean Lambert MEP (Angli) [Kryetare e delegacionit për Azinë Jugore në Parlamentin European] dhe **Phil Benninon MEP (Angli)** [Anëtar i delegacionit për Azinë Jugore në Parlamentin European dhe kryetar i grupit Liberal Demokrat në Parlamentin European]. Të dy deputetët njoftuan Kalifin rreth vizitës së tyre të fundit në Pakistan. Ata gjithashtu prematuan për të ndihmuar muslimanët ahmedianë që përballen me persekutim. Kalifi u tërhoqi vëmendjen duke u thënë që duhet bërë përpjekje për të ndaluar

radikalizimin e fëmijëve të pafajshëm në Pakistan si dhe të ashtuquajturat medrese nuk po përmbushin detyrat e tyre të përhapjes së edukatës fetare, përkundrazi ata po indoktrinojnë me ideologjitë ekstremiste. Kalifi shtoi që “pa ndonjë arsim të mirëfilltë, njerëzit mund të ndikohen dhe të indoktrinojnë lehtësisht.”

Marina Yannakoudakis MEP (Angli) tha se ajo gjithmonë ka admiruar moton e Xhematit Musliman Ahmedia “Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd.” Si



përgjigje Kalifi i tha se “ky është një mesazh, që vlen për mbarë botën.”

Billy Teranger (*CF Party*), **Ann Katherine Skgorshammer** (*deputet – CF Party*) Billy Teranger shprehu admirimin e tij për muslimanët ahmedianë. Hazret Mirza Masroor Ahmedi ^{a.b.t.a} i tha që të gjithë, njerëz të drejtë dhe të mençur duhet të mbështesin mesazhin e xhematit të dashurisë, paqes dhe të harmonisë. Këta politikanë gjithashtu thanë se kanë vizituar xhaminë e re të xhematit në Oslo dhe ajo është një burim krenarie për popullin norvegjez.

Ingrid Norstein (Labour Party, Norvegji) znj. Ingrid Norstein shprehu kënaqësinë e saj gjatë takimit me Hazret Mirza Masroor Ahmed. Ajo tregoi që ka marrëdhënie shumë të mira me Xhematin Musliman Ahmedia në Norvegji dhe kohët e fundit ka studiuar mjaft rreth xhematit. Ajo e pyeti Hazret Mirza Masroor Ahmedin sesi qeveria norvegjeze mund ta ndihmojë Xhematin Musliman Ahmedia. Shkëlqesia e tij iu përgjigj që muslimanët ahmedianë besojnë bindshëm që të gjithë qytetarët duhet të gëzojnë të drejta të barabarta. Për



shkak të një ligji të padrejtë dhe shtypës, muslimanëve ahmedianë u është mohuar e drejta e votimit në Pakistan. Qeveria norvegjeze duhet të punojë për të siguruar që të gjitha shtresat të kenë të drejtën për të votuar.

Delegacioni spanjoll - Jose Maria Alonso Ruiz, (Deputet), Pedro Carlavilla (kryebashkiaku i Meco) dhe Augustina Rubio (avokat & profesor) – Fillimisht Hazret Mirza Masroor Ahmedi është bërë i ditur me situatën aktuale ekonomike në Spanjë. Shkëlqesia e tij porositi që fondet që ka marrë

Spanja si pjesë e marrëveshjes së plan shpëtimit me Bashkimin European duhen shpenzuar me maturi dhe për mirëqenien e popullit spanjoll. Ai gjithashtu uroi që gjendja ekonomike e Spanjës të përmirësohet dhe vendi të shënojë progres. Ai gjithashtu shprehu simpatinë e tij për Spanjën dhe tha se i pëlqen klima si dhe populli spanjoll.

Garry O'Halloran – (Avokat nga Irlanda) Hazret Mirza Masroor Ahmedi u prezantua me Garry O'Halloran, një avokat nga Irlanda, i cili ka lënë karrierën politike për veprimtarinë e tij ligjore. Kalifi u lut për të, për sukseset në të ardhmen.



Konferenca për shtyp

Më 4 dhjetor, një konferencë ndërkombëtare ishte organizuar në Sallën e Shtypit pranë Parlamentit Europian para se të zhvillohej evenimenti kryesor dhe Shkëlqesia e tij të mbante fjalimin kyç. Shkëlqesia e tij iu përgjigj pyetjeve të shumta të medias gjatë konferencës për shtyp, e cila zgjati dyzet e pesë minuta. Në këtë konferencë morën pjesë gazetarë nga Anglia, Spanja, Franca, Belgjika, Pakistani dhe vende të tjera. Duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarit të BBC-së në lidhje me rolin e Islamit në botë, Shkëlqesia e tij tha: “Mesazhi i Islamit për

paqen është universal, andaj motoja jonë thotë “dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd.” Duke dëgjuar përfaqësuesin e medias spanjolle, Ai tha se të gjitha fetë e mëdha në formën e tyre origjinale, japin mesazhin e paqes dhe muslimanët e vërtetë besojnë në të gjithë profetët. Secili profet ka përcjellë mesimin se Zoti është vetëm Një. Duke iu përgjigjur pyetjes së një përfaqësuesi të medias Malteze, Shkëlqesia e tij u shpreh se detyra e muslimanëve ahmedianë është që t’ia afrojnë botën Zotit dhe të ndërgjegjësojnë popujt e botës ndaj detyrës së tyre për të mbrojtur të drejtat e njeri-tjetrit.



Evenimenti kryesor

Evenimenti kryesor u zhvillua përpara një audience të ngjeshur. Kryetari dhe zëvendëskryetari i grupit “Miq të e Muslimanëve Ahmedianë” në Parlamentin Europian dolën në podium për t’i shprehur mirëseardhjen Hazret Mirza Masroor Ahmedit ^(Allahu endihmofte fuqimisht). Martin Schulz, MEP dhe Presidenti i Parlamentit Europian, gjithashtu bëri një vizitë të veçantë për të takuar Shkëlqesinë e tij. Para fjalimit kryesor, një sërë deputetësh iu drejtuan audiencës dhe shprehën admirimin e tyre për një Islam paqësor, përfaqësuar nga Xhemati

Musliman Ahmedia. Dr. Charles Tannock MEP dhe kryetari i grupit “Miq të e Muslimanëve Ahmedianë” në Parlamentin Europian tha se “Muslimanët ahmedianë janë shembulli më i shkëlqyer i tolerancës në botë”. Ai dënoi persekutimin e muslimanëve ahmedianë në Pakistan dhe tha “Motoja ahmediane *dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd*, është kundërpërgjigja më e denjë për xhihadietë e ekstremistët. Tunne Kelam MEP zëvendëskryetari i grupit “Miq të e Muslimanëve Ahmedianë” në Parlamentin Europian u shpreh se ai po merrte pjesë në këtë manifestim sepse kjo ishte një mundësi për “t’u bashkuar

në shpresën e paqes”. Ai gjithashtu lavdëroi Xhematin Musliman Ahmedia për “mospranimin e çdo lloj dhune dhe terrori” dhe artikuloi gatishmërinë e tij për të përkrahur Xhematin në mbarë botën. Baronesha Sarah Ludford MEP, zëvendëskryetare e grupit “Miqte e Muslimanëve Ahmedianë” në Parlamentin Europian, përmendi lidhjen e saj të gjatë me Xhematin Musliman Ahmedia në Angli. Ajo u shpreh se motoja e Xhematit është “një frymëzim që na nevojitet fort në botën moderne.” Claude Moraes MEP, zëvendëskryetare e grupit “Miqte e Muslimanëve Ahmedianë” në Parlamentin Europian tha që ky eveniment ka tërhequr “një pjesëmarrje më të gjerë sesa ne kemi në përgjithësi në ndonjë miting në Parlamentin Europian.” Ai gjithashtu shtoi se ka nevojë për të njohur më shumë Xhematin Musliman Ahmedia për shkak të “angazhimit të tij në shërbimet shëndetësore, për përpjekjet e tij për t’i shërbyer njerëzimit pa paragjykimë dhe për përkushtimin absolut për arsimin e

djemve dhe të vajzave.” Jean Lambert MEP, kryetarja e Delegacionit të Parlamentit Europian për Azinë Jugore, tha se ajo do të ndjekë çështjen e së drejtës së votimit të muslimanëve ahmedianë me qeverinë pakistaneze. Ajo u shpreh se është e domosdoshme që të gjithë popujt të gëzojnë të drejtën e votimit lirisht dhe pa asnjë diskriminim. Presidenti kombëtar i Xhematit Musliman Ahmedia në Angli, Rafik Hajat, shprehu kënaqësinë e tij për themelimin e grupit “Miqte e Muslimanëve Ahmedianë” në Parlamentin Europian. Ai gjithashtu parashtroi një paraqitje të shkurtër rreth Xhematit Musliman Ahmedia. Këtu po paraqesim fjalimin historik të Hazret Mirza Masroor Ahmedit

Allahu e ndihmoftë fuqimisht, Kalifatul Masih V, Udhëheqës botëror i Xhematit Musliman Ahmedian.



Në emër të Allahut të
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

*Es-selamu alejkum ue rahamtullah ue
brakatuhu*

Të nderuar mysafirë,

Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin
mbi ju!

Së pari, dua të falënderoj organizatorët e këtij evenimenti, të cilët ma mundësuan këtë rast që t'ju drejtohesha juve të gjithëve këtu në Parlamentin European. Dua të falënderoj edhe të gjithë delegatët që përfaqësojnë shtete të ndryshme si dhe miq të tjerë, të cilët kanë bërë mjaft përpjekje për të qenë të pranishëm në këtë eveniment. Ata, që tashmë janë të njohur mirë me Xhëmatin Musliman Ahmedia, ose ata që nuk e njohin mirë, por kanë raporte të ngushta me individë ahmedianë, do të jenë plotësisht të vetëdijshëm që ne, si një bashkësi, në mënyrë të vijueshme, i tërheqim vëmendje botës ndaj vendosjes së paqes dhe sigurimit. Sigurisht, ne orvatemi për t'i arritur këto qëllime duke shfrytëzuar të gjitha resurset tona. Unë, si kryetar i Xhëmatit Musliman Ahmedia, vazhdimisht i trajtoj këto çështje sa herë që më jepet mundësia. Fakti, që unë po flas për nevojën e paqes dhe të dashurisë së ndërsjellë, nuk buron nga ndonjë doktrinë e re e xhëmatit Musliman Ahmedia, edhe nëse është plotësisht e vërtetë që

vendosja e paqes dhe e pajtimit ishte një ndër objektivat më kryesore të ardhjes së themeluesit të Xhematit Musliman Ahmedia. Megjithatë, e vërteta është që të gjitha sjelljet tona bazohen në mësimet, të cilat i ishin shpallur themeluesit të shenjtë të Islamit, Profetit Muhammed s.a.v.s. Mësimet e pastra që solli ai, fatkeqësisht ishin lënë qekur në harresë nga shumica e muslimanëve, përgjatë këtyre katërmbëdhjetë shekujve pas tij. Andaj, për të ripërtërirë Islamin e vërtetë, Allahu i Lartësuar dërgoi Mirza Ghulam Ahmedin, themeluesin e xhematit Musliman Ahmedia në Kadijan, në përputhje me profecitë e Profetit Muhammed s.a.v.s.

Ju lutem, mbajeni parasysh këtë pikë, kur do të flas rreth mësimëve të Islamit, në lidhje me promovimin e paqes dhe harmonisë në botë.

Mua më duhet që të shkoqis fill e për pe se paqja dhe siguria përfshijnë shumë aspekte, sepse ashtu siç çdo pjesë mban rëndësi të madhe në vetvete, po kështu edhe mënyra siç ato ndërlidhen është mjaft e

rëndësishme. Për shembull, blloqet themelore të ndërtimit të paqes në shoqëri janë qetësia dhe harmonia brenda shtëpisë. Situata brenda një shtëpie nuk është e kufizuar por, ajo nxit efekte që i sjellin pasoja paqes së asaj lagjeje, gjë e cila si rrjedhim ndikon në paqen e mbarë zonës apo qytetit. Nëse ka çrregullim në shtëpi, atëherë kjo si rrjedhojë do të ndikojë keqas në paqen e gjithë lagjes apo qytetit, kështu në të njëjtën mënyrë edhe gjendja e lagjes apo qytetit ndikon në paqen e gjithë shtetit, dhe rrjedhimisht kjo situatë do t'i sjellë pasoja të padëshiruara jo vetëm rajonit por mbarë botës. Andaj, është mjaft e qartë se nëse ju dëshironi të diskutoni qoftë edhe njërin nga aspektet e paqes, do të kuptoni se asaj nuk mund t'i vihen caqe, përkundrazi ajo zgjerohet gjithnjë e më shumë.

Po kështu, ne shohim se aty ku mungon paqja, nevojiten metoda të ndryshme për të zgjidhur problem, të cilat duhet të bazohen në problemin ekzistues si dhe mbi aspekte të veçanta të paqes dhe sigurisë, të cilat janë cenuar rëndë. Nëse do ta kemi

parasysh këtë, atëherë do të jetë e qartë që diskutimi i hollësishëm dhe trajtimi i plotë i këtyre çështjeve kërkon shumë më tepër kohë sesa kemi në dispozicion. Megjithatë, do të orvatem, të përfshij së paku disa nga aspektet e mësimave të vërteta të Islamit.

Në botën moderne, shohim që ngrihen kritika të ashpër drejtuar Islamit, dhe pjesa më e madhe e përgjegjësisë për çrregullimin dhe konfliktet në botë i atribuohet religjionit. Akuza të tilla ngrihen edhe nëse vetë kuptimet e fjalës Islam janë paqe dhe siguri. Po kështu, Islami është ajo fe, e cila parashtron udhëzime të posaçme sesi mund të vendoset paqja dhe paraqet edhe udhëzimet për ta arritur këtë.

Para se t'ju ilustroj përshkrimin e mësimave të vërteta dhe paqësorë të *Islamit*, dua të diskutoj shkurtimisht gjendjen aktuale të botës. Jam i sigurt që ju të gjithë jeni mjaft të informuar rreth këtyre çështjeve. Por, unë dua t'i prek ato çështje, me qëllim që t'i keni parasysh ato kur do të diskutoj për mësimet e Islamit rreth paqes

Qeveritë duhet të hartojnë ato politika, të cilat vendosin dhe mbrojnë respektin reciprok, përmes të cilave cenimi i ndjenjave të të tjerëve si dhe shkaktimi i çfarëdo dëmi, të konsiderohen veprime të jashtëligjshme.

dhe harmonisë. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm dhe pranojmë që bota e sotme është kthyer në një fshat global. Ne të gjithë jemi ndërlidhur me njëri-tjetrin me anë të mjeteve të ndryshme. Këto mund të jenë mjete të reja të transportit, medias, internet, apo mjete të tjera. Të gjithë këta faktorë kanë kontribuar në afrimin e shteteve të botës me njëri-tjetrin si kurrë më parë. Ne shohim që në vendet e mëdha,

janë vendosur popujt e të gjitha racave, feve dhe kombësive, dhe ata jetojnë bashkërisht. Në fakt, në shumë vende, popullsia e emigrantëve të huaj ka numër të konsiderueshëm. Emigrantët janë integruar aq mirë në këto vende, sa që do të jetë mjaft e vështirë madje e pamundur që qeveritë apo popullsia vendëse t'i përzënë ata. Ndonëse, janë bërë orvatje për t'i vënë frenat imigrimit, dhe janë aplikuar disa sanksione të posaçme, akoma ka mjaft mënyra me anë të cilave shtetasi i një vendi mund të hyjë në një shtet tjetër.

Në fakt, duke lënë mënjanë emigrimin e paligjshëm, ekzistojnë edhe disa ligje ndërkombëtare, të cilat u vijnë në ndihmë atyre personave, që detyrohen për të emigruar për shkak të arsyeve të drejta. Ne gjithashtu shohim që si pasojë e emigrimit masiv, në disa shtete të caktuara, po përhapet ndjeshëm indinjatë dhe nervozizëm. Përgjegjësia për këtë bie mbi të dyja palët, si mbi emigrantët edhe mbi popullsinë vendëse. Nga njëra anë, disa emigrantë provokojnë vendasit duke refuzuar të integrohen në ndonjë mënyrë, në anën tjetër

disa nga vendasit shfaqin mungesën e tolerancës dhe zemërgjerësisë. Pak nga pak, urrejtja ngjizet, derisa arrin në shkallën e rrezikshmërisë. Në veçanti, si reagim ndaj sjelljes së keqe të disa muslimanëve dhe veçanërisht të emigrantëve, urrejtja dhe indinjata e popullatës lokale në vendet perëndimore, shpesh nxjerr kryet ndaj Islamit. Ky zemërim dhe reagim nuk i përmbahet një shtrirjeje të kufizuar, por përhapet dhe sigurisht vrulltas merr përmasa të mëdha. Për këtë arsye, edhe liderët perëndimorë, shpeshherë i cekin këto probleme. Andaj, në raste të ndryshme dëgjojmë Kancelaren gjermane duke mëtuar se muslimanët janë pjesë e Gjermanisë. Po kështu, edhe kryeministri britanik nënvizon rëndësinë e integritetit të muslimanëve. Madje, liderët e disa shteteve kanë shkruar me tutje, duke lëshuar deklaratat me ton kërcënues ndaj muslimanëve. Edhe pse nuk po acarohet më gjendja e brendshme e mosmarrëveshjeve, të paktën ajo ka mbetur mjaft shqetësuese. Këto çështje mund të mahisen më keq dhe mund të na shpien deri në prishjen e paqes. Nuk ka asnjë dyshim se



pasojë e këtyre konflikteve nuk do të kufizohet vetëm në Perëndim, por do të ndikojë në gjithë botën, dhe në veçanti në vendet muslimane. Kjo do të shkaktojë ashpërsimin e marrëdhënieve bilaterale midis botës Perëndimore dhe asaj Lindore. Andaj, nevoja për të përmirësuar situatën dhe për të vendosur paqen kërkon që të gjitha palët të punojnë bashkërisht. Qeveritë duhet të hartojnë ato politika, të cilat vendosin dhe mbrojnë respektin reciprok, përmes të cilave cenimi i ndjenjave të të tjerëve si dhe shkaktimi i çfarëdo dëmi, të konsiderohen veprime të jashtëligjshme. Për sa u përket emigrantëve, ata duhet të vijnë me gatishmërinë për t'u integruar me

popullatën vendase, po kështu edhe popullata vendase duhet të jetë e gatshme për t'ua hapur zemrën dhe për të qenë tolerante.

Veç kësaj, thjesht imponimi i disa sanksioneve kundër muslimanëve nuk vendos paqen, sepse nuk janë sanksione ato që mund të ndryshojnë mendjen dhe pikëpamjet e njerëzve. Kjo nuk është e kushtëzuar vetëm me muslimanët, madje, kushdoqoftë, sa herë që shtypet forcërisht, për shkak të fesë a besimit të tij, shkakton kundërveprim negativ, i cili e dëmton rëndë paqen.

Sikundër kam thënë, në shumë shtete, konfliktet po përkeqësohen, në veçanti midis popullatës vendase



Kryetari i Parlamentit Evropian
z. Martin Schulz, duke u për-
shëndetur me Kalifin e Xhematit
Musliman Ahmedia.

dhe emigrantëve muslimanë. Është e qartë që të dyja palët po bëhen gjithnjë e më pak tolerante dhe ka një mosdashje për të njohur njëri-tjetrin.

Udhëheqja europiane duhet ta pranojë këtë realitet dhe duhet të kuptojë që ajo mban përgjegjësi për vendosjen e respektit të ndërsjellë fetar dhe të tolerancës. Kjo është e domosdoshme për t'i çelur rrugë ambientit të dashamirësisë dhe për të mos shkatërruar paqen globale. Unë besoj që shkaku i këtyre

konflikteve dhe ndarjeve, nuk është vetëm feja apo besimi, dhe kjo nuk është thjesht një pyetje për dallimet mes shteteve Perëndimore dhe atyre muslimane. Në fakt shkaku kryesor i mosmarrëveshjes e ka pikënisjen në krizën financiare globale. Kur nuk qe inflacioni apo kreditë e këqija askush nuk u bë merak për flukse emigrantësh muslimanë, jomuslimanë apo afrikanë, por situata sot është kryekëput ndryshe, gjë ka sjellë këto pësioja. Ajo ka ndikuar edhe në marrëdhëniet reciproke të shteteve europiane, kështu që indinjata dhe mllefi midis popujve europiane po çoroditet përditë e më shumë. Kjo gjendje dëshpërimi është e dukshme kudo.

Formimi i Bashkimit Europian është një arritje madhështore për shtetet europiane, sepse ai shërben për ta bashkuar këtë kontinent. Andaj, duhet të bëni të gjitha përpjekjet e mundshme për ta mbrojtur këtë bashkim, duke respektuar të drejtat e njëri-tjetrit. Frika dhe shqetësimet e popullit duhen neutralizuar. Për të mbrojtur shoqërinë e njëri-tjetrit, ju duhet të tregoni gatishmëri për të pranuar kërkesat e drejta dhe të ligjshme të njëri-tjetrit. Sigurisht, këto kërkesa të drejta dhe të ligjshme duhen bërë nga popujt e çdo shteti. Të dini që fuqia e Europës qëndron nëse ajo mbetet e bashkuar dhe e njësuar në një të vetme. Një bashkim i tillë, nuk do t'ju sjellë dobi vetëm juve këtu në Europë, por do t'i mundësojë këtij kontinenti të përmbajë forcën dhe ndikimin e tij në nivel botëror.

Në fakt, duke folur nga këndvështrimi islamik, ne duhet të vazhdojmë përpjekjet tona për të bashkuar gjithë botën në një të vetme. Në lidhje me monedhën, bota duhet të jetë e bashkuar. Në lidhje me tregun e lirë dhe biznesin, bota

Në fakt, duke folur nga këndvështrimi islamik, ne duhet të vazhdojmë përpjekjet tona për të bashkuar gjithë botën në një të vetme. Në lidhje me monedhën, bota duhet të jetë e bashkuar. Në lidhje me tregun e lirë dhe biznesin, bota duhet të jetë e bashkuar. Në lidhje me lëvizjen e lirë dhe emigrimin, duhen hartuar politika të unifikuara dhe të volitshme, me qëllim që bota të bashkohet.

duhet të jetë e bashkuar. Në lidhje me lëvizjen e lirë dhe emigrimin, duhen hartuar politika të unifikuara dhe të volitshme, me qëllim që bota të bashkohet.

Pra, në thelb, shtetet duhet të kërkojnë të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, me qëllim që ndarjet



të zëvendësohen me unifikimet dhe bashkimet. Nëse, këto masa ndërmerren, atëherë në një të ardhme shumë të afërt, konfliktet aktuale do të marrin fund, dhe në vend të tyre do të sundojë paqja dhe respekti reciprok, por me kusht që ata të veprojnë me drejtësi absolute dhe çdo shtet t'i përmbahet përgjegjësisë së tij.

Më duhet të shprehem me shumë keqardhje, se ndonëse ky është mësimi i fesë Islame, shtetet muslimane nuk kanë arritur të bashkohen me njëri-tjetrin. Nëse do të kishin mundur të bashkëpunonin dhe të unifikoheshin, atëherë vendet musli-

mane nuk do të kishin më nevojë që t'u kërkonin ndihmë vendeve perëndimore për t'i zgjidhur nevojat dhe problemet e tyre të brendshme.

Tani dua të flas për mësimet të vërteta të Islamit në lidhje me vendosjen e paqes së qëndrueshme në botë. Në radhë të parë, mësimi themelor dhe kryesor i Islamit thotë: “muslimani i vërtetë është ai person, nga dora dhe gjuha e të cilit, janë të sigurt të gjithë njerëzit e tjerë paqedashës. Ky është përkufizimi i një muslimani paraqitur nga Profeti Muhammed s.a.v.s. Pas këtij parimi të bukur themelor, a mund të ngrihet ndonjë akuzë apo ankesë

kundër Islamit?! Sigurisht që jo. Sipas Islamit, vetëm ata që përdorin gjuhët dhe duart e tyre për të përhapur padrejtësinë dhe urrejtjen, meritojnë të ndëshkohen. Kështu që, nga niveli lokal deri te niveli global, nëse të gjitha palët i përmbahen këtij parimi të artë, atëherë kurrë nuk do të ketë ndonjë çrregullim fetar, grevë politike e as trazira bazuar në lakmi dhe në dëshirë për të fituar fuqi. Nëse zbatohen këto parime të Islamit, atëherë brenda shteteve, vetë popujt do të kujdesen për të drejtat dhe ndjenjat e njëri-tjetrit, ndërsa qeveritë do t'i përgjigjen detyrës së tyre për të mbrojtur të gjithë qytetarët e tyre. Ndërsa në shkallë ndërkombëtare, secili shtet do të bashkëpunojë me një shpirt dashamirësie dhe dhembshurie me shtetin tjetër. Një tjetër parim kryesor që parashtron Islami është që në vazhde të përpjekjeve për vendosjen e paqes, nevojitet që palët të mos shfaqin arrogancë apo krenari në çfarëdolloj forme. Këtë parim e jetësoi shkëlqyeshëm i Dërguari i Allahut s.a.v.s. kur ai tha këto fjalë të arta: "Një njeri me ngjyrë nuk ka asnjë epërsi ndaj një të bardhi, e as

një i bardhë nuk gëzon epërsi mbi një njeri me ngjyrë. Pra, nëse një evropian nuk është më i lart apo më i madh sesa qytetarë të tjerë, po kështu as afrikanët, aziatikët apo popujt e çfarëdo vendi tjetër të botës, nuk gëzojnë asnjë superioritet të veçantë. Dallimet e kombësisë, ngjyrës apo etnitetit, shërbejnë vetëm si mjete për të identifikuar. E vërteta është që në botën moderne, ne të gjithë varemi nga njëri-tjetri. Madje, fuqitë e mëdha siç është Europa apo Shtetet e Bashkuara, nuk mund të mbijetojnë duke qenë plotësisht të izoluara nga vende të tjera. As vendet afrikane nuk mund të mbeten të ngujuara dhe njëherazi të shpresojnë për t'u zhvilluar, po kështu edhe vendet aziatike apo popujt nga cilado pjesë e botës. Për shembull, nëse dëshironi që ekonomia juaj të lulëzojë, atëherë ju duhet të tregoni gatishmëri për të përqafuar tregtinë ndërkombëtare.

Një shembull i qartë për të shkoqitur sesi bota është ndërthurur sot, përshkruhet nga fakti se kriza Europiane apo botërore e disa viteve të fundit u ka sjellë dëm pak a shumë

çdo vendi të botës. Po kështu, edhe për të përparuar në shkencë si dhe për të zhvilluar më tej ekspertizat në fusha të ndryshme, shtetet kanë nevojë që të bashkëpunojnë dhe të mbështesin njëri-tjetrin. Ne duhet të dimë që Zoti i Lartësuar u ka dhënë të gjithë popujve të botës aftësi të jashtëzakonshme intelektuale, qofshin ata nga Afrika, Europa, Azia ose kudo tjetër. Nëse të gjithë popujt shfrytëzojnë aftësitë e tyre duke përdorur të gjitha mundësitë për mirëqenien e njerëzve, atëherë do të shohim që bota do të shndërrohet në një parajsë paqësore. Megjithatë, nëse vendet e zhvilluara tentojnë të pengojnë rritjen dhe progresin e vendeve më pak të zhvilluara dhe të atyre që janë në zhvillim, dhe nuk krijojnë mundësitë për mendjet e shëndosha dhe të mprehta të këtyre shteteve, atëherë nuk duhet të ketë asnjë dyshim që indinjata do të përhapet, dhe çrregullimi që e pason do ta shkatërrojë paqen dhe sigurinë e mbarë botës.

Për vendosjen e paqes, një tjetër parim i Islamit thotë se nuk duhet të tolerojmë padrejtësinë ndaj të

tjerëve, por duhen mbrojtur të drejtat e tyre. Ashtu sikurse nuk mund të pranojmë që dikush të rrëmbejë të drejtat tona, po kështu nuk duhet të pajtohemi me padrejtësinë ndaj të tjerëve. Islami këshillon që edhe kur duhet të veprojmë me masa të rrepta, ato duhet t'i përgjigjen aktit keqbërës. Megjithatë, nëse falja mund t'i paraprijë reformimit, atëherë duhet zgjedhur mundësia e faljes.

Qëllimet kryesore dhe gjithëpërfshirëse duhet të jenë gjithmonë reformimi, pajtimi dhe vendosja e paqes së qëndrueshme. Megjithatë, ajo që ndodh në realitet, kur dikush bën një shkelje apo padrejtësi, viktimi kërkon të hakmerret në një mënyrë plotësisht të pajustificueshme dhe joproporcionale, madje shumë herë më të madhe se padrejtësia e bërë. Pikërisht, këtë e dëshmojmë këto ditë në konfliktin e shkallëzuar midis Izraelit dhe Palestinës. Fuqitë e mëdha kanë shprehur keqardhjen dhe shqetësimin e tyre për situatën në Siri, Liban ose në Egjipt, edhe



pse mund të argumentohet që ato në thelb janë çështjet e tyre të brendshme, por nuk duket se ato janë të shqetësuar për popullin palestinez. Ky standard i dukshëm i dyfishtë, po u shton mëri dhe urrejtje në zemrat e popujve të shteteve muslimane ndaj shteteve të fuqishme. Kjo indinjatë dhe antipati është mjaft kërcënuese, e cila duke u gurgulluar mund të shpërthejë në çdo moment. Cili mund të jetë rezultati i kësaj? Sa dëm mund t'i shkaktojë kjo botës në

zhvillim? A do të mund të mbijetojë ato? Sa shumë do të ndikohen vendet e zhvilluara? Të gjitha këto përgjigje janë vetëm në dijen e Zotit. Unë nuk mund t'u përgjigjem këtyre pyetjeve dhe as dikush tjetër. Por, për një gjë mund të jemi të sigurt, që paqja botërore do të shkatërrohet. Le të jetë e qartë, që unë po flas në mbështetje apo favor të ndonjë shteti të caktuar. Ajo që dua të them është që të gjitha format e mizorisë, kudo gjenden ato, duhen asgjësuar dhe



Kalifi i Xhematit Musliman Ahmedia, duke udhëhequr lutje solemne pas përfundimit të fjalimit, në Parlamentin Evropian.

duhen ndaluar, pa marrë parasysh se ato kryhen nga populli palestinez, populli izraelit apo populli i cilitdo shteti tjetër. Mizoritë duhen ndaluar me çdo kusht, sepse nëse ato lejohen të përhapen, atëherë flakët e urrejtjes sigurisht do të përpijnë gjithë botën, deri në shkallën që njerëzit shumë shpejt do të harrojnë vuajtjet e shkaktuara nga kriza e sotme ekonomike. Madje, ata do të përballen me një situatë tepër të tmerrshme. Do të ndodhë një humbje aq e madhe e jetëve njerëzore sa s'mund të merret me mend. Andaj, është detyra e vendeve europiane, të

cilat mbartën vuajtje të mëdha gjatë Luftës së Dytë Botërore, të marrin mësim nga e kaluara e tyre dhe të shpëtojnë botën nga shkatërrimi. Për ta përmbushur këtë, u duhet që t'u përmbahen me çdo kusht kërkesave të drejtësisë dhe të jenë të gatshëm për të pranuar përgjegjësinë e tyre.

Islami na tërheq vëmendje mbi rëndësinë e të vepruarit me drejtësi dhe paanshmëri në çfarëdo rasti. Ai mëson që asnjë pale nuk duhet t'i jepen padrejtësisht trajtime të favorizuara dhe preferenciale. Qëndrimi duhet të jetë i tillë që shteti keqbërës duhet të jetë i vetëdijshëm që nëse ai tenton të veprojë padrejtësisht ndaj shtetit tjetër, atëherë pa marrë parasysh madhësinë dhe statusin e

tij, bashkësia ndërkombëtare nuk do ta lejojë të bëjë një gjë të tillë. Nëse shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, shtetet që marrin ndihmë nga Bashkimi European, shtetet që janë nën influencën e fuqive të mëdha si dhe ato të pazhvilluara, arrijnë në një konsensus për t'iu përmbajtur këtyre parimeve, atëherë, dhe vetëm atëherë, paqja mund të kthehet në realitet. Po kështu, nëse shtetet me të drejtë vetoje në Kombet e Bashkuara, bëhen me dije që ata janë të detyruar të japin llogari për sjelljet e tyre, atëherë me të vërtetë paqja mund të vendoset. Në fakt, do të kaloj një hap më tej dhe do të pohoj se e drejta për të vënë veto, assesi nuk mund të lejojë apo të mbështesë vendosjen e paqes, sepse qartësisht të gjitha vende nuk qëndrojnë në të njëjtin nivel. Kjo është ajo pikë, të cilën kam ngritur edhe para pak kohe gjatë këtij viti, duke u drejtuar politikanëve të shquar dhe politikëbërësve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Capitol Hill. Nëse do t'i hidhni një vështrim historisë së votimeve të Kombeve të Bashkuara, do të gjeni që jo gjithmonë ato janë

përdorur për të përkrahur ata që janë shtypur ose kanë vepruar me drejtësi, por në disa raste flagrante, e drejta për të vënë veto është keqpërdorur për të mbrojtur dhe për të stimuluar dhunën, dhe jo për ta ndaluar atë. Kjo nuk është diçka e fshehtë apo e panjohur, por një fakt për të cilin analistët janë shprehur haptas.

Sipas një tjetër parimi të bukur të Islamit, paqja në shoqëri kërkon që njeriu të mposhtë zemërimin e tij, e jo ta lejojë që të kaplojë parimet e ndershmërisë dhe të drejtësisë. Historia fillestare e Islamit vërteton që muslimanët e vërtetë gjithmonë iu përmbajtën këtij parimi, sa për ata që nuk iu nënshtruan, janë qortuar rëndë nga Profeti Muhammed s.a.v.s. Por, fatkeqësisht, këto rrethana nuk përputhen gjithmonë me situatën e sotme. Ka mjaft raste, kur ushtritë dërguar për të vendosur paqe, sillen në një mënyrë krejtësisht të papajtueshme me detyrën e ngarkuar. Për shembull, në disa shtete, ushtarët e huaj kanë përdorur metoda nga më çnjerëzoret dhe rrëqethëse, me kufomat e viktimave

të tyre. A mund të arrihet paqja në këtë mënyrë? Kundërveprimi ndaj kësaj sjelljeje nuk mund të mbetet i përqendruar vetëm brenda kufijve të shtetit përfshirës, por ai shfaqet gjithkund në botë. Dhe sigurisht, nëse muslimanët keqtrajtohen, atëherë muslimanët ekstremistë shfrytëzojnë atë rast dhe si rrjedhojë paqja e botës sërisht do të priset, edhe pse sjellja e tyre u kundërvihet mësimëve të Islamit.

Islami mëson që paqja mund të arrihet vetëm duke përkrahur të dyja palët, të shtypurin dhe shtypësin, në një mënyrë thellësisht të paanshme, të pavarur nga interesa të ulëta dhe të lirë nga çdolloj armiqësie. Paqja mund të ndërtohet, vetëm duke u mundësuar të gjitha partive platformë të përbashkët.

Meqë koha është e kufizuar, prandaj dua të cek edhe një çështje tjetër. Islami mëson që pasuritë dhe resurset e të tjerëve nuk duhen vëzhguar me vështrim ziliqar. Ne nuk duhet ta lakmojmë atë që u përket të tjerëve, sepse kjo është gjithashtu

një shteg për shkatërrimin e paqes. Nëse shtetet e pasura, përpiqen të përvetësojnë apo të shfrytëzojnë pasuritë dhe resurset e shteteve më pak të zhvilluara vetëm për të ngopur nevojat e tyre, atëherë sigurisht kjo do të shkaktojë indinjatë dhe zemërim. Ndonëse shtetet e zhvilluara mund të marrin sasinë e merituar dhe të drejtë, në këmbim të shërbimeve të tyre, shumica e këtyre resurseve duhen shfrytëzuar për të asistuar shtetet e pazhvilluara që të ngrenë standardet e jetesës. Ata duhen lejuar të përparojnë dhe duhen përkrahur në përpjekjet e tyre, për të arritur të njëjtin nivel me vendet e zhvilluara, sepse vetëm atëherë paqja mund të vendoset. Nëse lidershhipi i këtyre vendeve nuk është i ndershëm, atëherë vendet e zhvilluara dhe ato perëndimore duhet të monitorojnë dhe të drejtojnë vetë zhvillimin e atyre vendeve duke u ofruar ndihma financiare.

Janë mjaft çështje të tjera që mund të shtjelloj, por, për shkak të kohës së pamjaftueshme, duhet të përmbahem vetëm në ato pika që ju kam shpjeguar. Sigurisht, gjithçka

që ju kam parashtruar përfaqëson
mësime të vërteta të Islamit.

Mbase mund t'ju lindë një pyetje
së cilës duhet t'i përgjigjem
paraprakisht. Mund të thoni që nëse
këto janë mësime të vërteta të Islamit,
atëherë pse vallë shohim aq përçarje
dhe çrregullime në botën muslimane.
Kësaj pyetjeje i jam përgjigjur që në
fillim, duke përmendur nevojën e
ardhjes së një reformatori, i cili sipas
besimit tonë ishte Mirza Ghulam
Ahmedi, themelues i Xhematit
Musliman Ahmedia. Ne, anëtarët e
këtij xhemati, gjithmonë orvatem
që të përcjellim këto mësime aq
gjerësisht sa të jetë e mundur.

Do t'ju lutesha të gjithëve që
të bëni përpjekje edhe ju për të
ngjallur sensibilizimin rreth këtyre
çështjeve brenda qarqeve tuaja të
ndikimit, me qëllim që të mund
të ndërtohet paqja e qëndrueshme
në të gjitha anët e botës. Nëse ne
dështojmë në këtë detyrë, atëherë
asnjë vend i botës nuk do të mbetet
i mbrojtur nga pasojat e tmerrshme
dhe shkatërruese të luftës. I lutem
Allahut të Plotfuqishëm që Ai t'u

mundësojë popujve të kësaj bote që
të kapërcejnë dëshirat dhe interesat
e tyre personale, si një përpjekje për
të mbrojtur botën nga shkatërrimi
që i avitet galop. Janë vendet e
zhvilluara të Perëndimit, të cilat
gëzojnë fuqinë, kryesisht në botën
aktuale, andaj mbi të tjerët, është
detyra juaj që t'u kushtoni vëmendje
të menjëhershme këtyre çështjeve
me rëndësi jetësore.

Në fund, dua t'ju falënderoj edhe një
herë që gjetët kohë për të ardhur këtu
dhe që dëgjuat fjalët e mia. Allahu ju
bekoftë! Ju falënderoj shumë!

(Revista Review of Religions, Londër,
Shkurt 2013, f. 42-63)

<http://www.reviewofreligions.org/download/RR201302.pdf>

Përktheu në shqip: Shahid Ahmad



Si mund të arrihet
paqja me vetveten?



“O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxitni njëri-tjetrin për të qenë të duruar.” [Ali Imran 3:199]

Sot, në shekullin XXI, jeta e njeriut është shumë ndryshe nga ajo që ka qenë në shekujt e mëparshëm. Ajo është shumë e shpejtë e dinamike dhe njeriu ka më pak kohë për t’ia kushtuar vetes apo familjes së tij, sepse rritja e mirëqenies, fitimi i sa më shumë parave apo arritja e një karriere të suksesshme janë shqetësimet më të përgjithshme, që kanë banorët e kësaj kohe. Pra ne ndodhemi larg të pasurit paqe shpirtërore dhe larg të qenit i kënaqur me veten. Duke pasur një mënyrë shumë dinamike të jetuari, njeriu i sotëm përdor lloje të ndryshme relaksimi për të shpëtuar nga ankthi që akumulon nga këto shqetësime të cilat i rrahin mendjen dhe zemrën çdo ditë. Disa nga këto dëfrime apo mënyra për të shpëtuar nga shqetësimet, janë ndër veprimet më të dëmshme për shoqërinë, si alkooli, droga, bixhozi

apo shturja nëpër vende argëtuese. Mirëpo këto mënyra të heqjes së stresit apo relaksimi sjellin një sërë pasojash negative, e kundërta e asaj që ata kërkojnë. Të gjithë e dimë që këto sjellin pasoja si: dhunë në familje, abuzime me fëmijët, rritje të agresivitetit, kalime në depresion dhe tendencë vetëvrasëse etj.

Para se ta shtjelloj këtë temë, dua t’ju njoh me disa statistika alarmante në lidhje me përdorimin e alkoolit, drogës si dhe me pasojat e lojërave të fatit.

Sipas raportit të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC) në 2010 rreth 230 milion apo 5% e popullatës së rritur kanë përdorur drogë, ndërsa numri i përdoruesve problematikë të drogës është 27 milion.^a

Sipas një raporti të Organizatës Botërore të Shëndetësisë çdo vit numri i vdekjeve nga përdorimi i alkoolit është afërsisht 2.5 milion. Çdo vit 320000 të rinj,

nga grupmoshat 15 deri 29 vjeç vdesin si pasojë e alkoolit. Pothuaj 9% e vdekjeve në këtë grupmoshë shkaktohen nga pirja e alkoolit. Alkooli është faktori i tretë kryesor në botë që shkakton sëmundje të rënda. Në vendet e Paqësorit, në Amerikën veriore apo jugore, alkooli përbën faktorin më të rrezikshëm për shëndetin, ndërsa në Europë ai renditet i dyti. Alkooli gjithashtu lidhet ngushtë me mjaft probleme shoqërore, siç janë dhuna në familje, neglizhenca dhe abuzimi ndaj fëmijëve dhe mungesa në vendet e punës.^b

SipasnjëstudimitëbërëngaQendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, konsumimi i tepërt i alkoolit, vetëm gjatë vitit 2006, i ka sjellë shtetit amerikan një dëm prej 223,5 miliard dollarë.^c

SipasForbes^d,treguglobalilojërave të fatit llogaritet të kapë shifrën prej 417 miliard dollarë. Ndërsa dhjetë shtetet që kanë kulturën më të gjerë të bixhozit janë^e:

Nr.	Shteti	Humbja vjetore e një lojtari
1.	Australia	\$ 1288
2.	Singapori	\$ 1174
3.	Irlanda	\$ 588
4.	Kanadaja	\$ 568
5.	Finlanda	\$ 553
6.	Italia	\$ 517
7.	Hongkongu	\$ 503
8.	Norvegjia	\$ 448
9.	Greqia	\$ 420
10.	Spanja	\$ 418

Por, paqja shpirtërore është një ndjenjë e brendshme për të cilën përmllohen shumë njerëz, por pak e arrijnë atë. Shumë njerëz kur nxiten e provokohen shfaqin pakënaqësi apo mërzitje në shkallë të ndryshme. Harmonia e vërtetë shpirtërore, ngulitet në mënyrë të përhershme në karakterin e një individi dhe pasqyrohet qartë në zërin e tij, në sjelljen dhe lëvizjet e trupit. Ajo është një mirësi e hareshme dhe hyjnore e cila rron brenda njeriut dhe i përcakton caqet e personalitetit gjatë gjithë kohës.

Paqja shpirtërore është një veti, e cila mund të përftohet dhe të

zhvillohet nga çdokush që sinqerisht dëshiron ta zotëroje atë. Përbërësit kryesor për të pasur sukses janë lutja, përqendrimi mendor, disiplina vetjake, vendosmëria dhe qëndrueshmëria. Këto i japin një hov dhe shtytje të fortë individit, në rrugëtimin e tij drejt qëllimit të tij madhor dhe shpejt ai do të përfjetojë një ndryshim të pastër brenda vetes. Megjithatë, ende nuk i duhet të pushojë duke u kënaqur me frytet e para të progresit. Njeriu duhet të ketë një dëshirë të zjarrtë për të ushtruar përpjekje për avancim të mëtejshëm dhe duhet të ruhet nga devijimet më të vogla që mund të çekuilibrojnë sinkroninë e tij shpirtërore. Teksa ai vazhdon të ecë përpara, paqja dhe harmonia kanë për të pushtuar gjithnjë e më fort mendimet dhe veprimet e tij, derisa vetëdija nuk do të nevojitet më të zëvendësohet nga natyra e dytë.

Personi që zotëron paqe mendore dhe shpirtërore nuk është indiferent ndaj brengave dhe dhimbjeve të jetës. Ai është mprehtësisht në dijeni të tyre, por ai i pranon ato në

një mënyrë të qetë e të përmbajtur saqë shpesh një vëzhgues mund të dështojë për të zbuluar ndonjë shenjë të emocioneve fizike të tij.

Individi që zotëron paqe shpirtërore kurrë nuk nxehet a shfryhet nga inati. Humbjet e një jete, humbjet në pasuri, në shëndet, apo persekutimet, vuajtjet, mërzitjet, apo vështirësitë nuk e thyjnë dot shpirtin e tij. Ndonëse, ai është plotësisht i vetëdijshëm për ndikimin e tyre, sjellja e tij mbetet e qetë dhe e përmbajtur mirë.

Zoti na tregon në Kuranin Famëllartë se Ai do ta sprovojë njeriun duke e bërë të kalojë përmes vuajtjeve të ndryshme, me qëllim, që të për-parojë me durim dhe këmbëngulje.

Sigurisht që Ne do t'ju provojmë pak me frikë dhe pak me uri, dhe pak me humbje të pasurisë, të njerëzve dhe të frutave! Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: "Ne jemi të Allahut dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!"

(Kurani 2:156,157)



Famous Japanese Garden Tree in Portland by Michael Matti Coypright CC BY-NC 2.0

Janë pikërisht momente fatkeqësish e hidhërimesh, kur njeriu testohet, dhe i jepet mundësia për të ushtruar dhe për të përshfaqur durimin dhe vetëpërmbytjen, pra majën e të gjitha virtyteve.

Por mposhtja e ndjenjave të padëshiruara nuk është aspak një punë e kollajshme. Lum ata që e arrijnë. Ka njerëz që konsiderohen sikurse bëjnë pjesë në elitën e shoqërisë që zotëron qetësinë

shpirtërore, por kur provokohen, nxjerrin fët në pah padurim dhe zemërim, përtej zhgënjimit të admiruesve të tyre.

Qëllimi im është që të tërheq vëmendjen e lexuesit ndaj bukurisë dhe vlerës së pakufishme të mendjes së qetë, dhe t'i ngjall atij entuziazëm e një dëshirë të zjarrtë për ta arritur këtë gjendje shpirtërore brenda vetes. Unë gjithashtu dua t'i ofroj

një udhërrëfyes praktik që t'i vijë në ndihmë në këtë udhëtim magjepsës drejt majave të pashkelura të formimit mendor e shpirtëror.

Për t'iu shmangur çdo dëmtimi apo ngasjeje e tundimi të mundshëm, është e udhës që të identifikohen qysh herët shenjat e para të rrezikut dhe të merren të gjitha masat e nevojshme paraprake e vetëmbrojtëse. Grumbullimi i reve të zeza në qiell paralajmëron ardhjen e një stuhie. Udhëtari duhet të kërkojë vend për t'u strehuar. Një grua shtëpiake do të nxitojë për t'i mbledhur rrobat e lëna për t'u tharë, ndërsa blegtori do të ruajë kopenë e tij. Të gjithë këta njohin shenjat e një stuhie të pashmangshme dhe përgatiten për një furtunë të rrëmbyer.

Është mjaft e rëndësishme që personi i cili po mundohet për të arritur gjendjen e qetësisë shpirtërore, të jetë i vëmendshëm dhe vigjilent ndaj çdo rasti apo situatë, të cilat mund ta shtyjë atë për të vepruar në një mënyrë shkatërruese dhe të kundërt nga fryma e shpirtit të qetë. Ai duhet të

jetë thellësisht i njohur me të gjitha rrethanat e jetës së përditshme, të cilat mund ta pengojnë apo rrëzojnë atë, dhe duke i vënë veshin sinjalit të alarmit, mbledh veten për të mos u gremisur.

Mungesa e vetëpërmbytjes hap portat e digës për vërshimin e ujërave të padurimit, nervozizmit, pakënaqësive, abuzimit, fyerjeve, sarkazmit, hidhërimit dhe të një sërë tipareve negative, të cilat të gjitha janë shkatërruese të qetësisë. Pra, ato duhen mposhtur me çdo kusht.

Një listë e veprimeve të përditshme që mund ta shtyjë njeriun për të shpërthyer mllëfin, vijnë si poshtë. Secila prej tyre është një sinjal paralajmërues. Ato duhen ngulitur në kujtesë, që të identifikohen menjëherë dhe mendja të ndërmarë hapat e menjëhershëm për mbrojtje. Secila prej tyre duhet pritur si një sfidë e një mundësi për të zhvilluar vetëpërmbytjen dhe kështu pak nga pak do të nënshtrohen të gjitha ndikimet shqetësuese dhe vetëpërmbytja do të pushtojë me sovranitet.

1. Zhurma

Shpeshherë zhurma është shkaktarja e nervave të acaruara, e mllëfit dhe fjalëve të ashpra. Edhe nëpër shtëpi dhe rrethin familjar, të gërthiturat e fëmijëve apo britmat e foshnjave u acarojnë nervat anëtareve të shtëpisë. Midis gjendjeve të tilla të rrëmujshme, Mesihu i Premtuar ^{alejhislam} shkroi disa nga kryeveprat e literaturës fetare, duke mos nxjerrë asnjë fjalë ankuese për atë gurgule të madhe që bëhej shpesh afër tij. Njëherë dikush e pyeti se si punonte aq i qetë dhe i pa shqetësuar midis zhurmave të banorëve të shtëpisë. Ai iu përgjigj se nuk i kushtonte vëmendje zhurmës dhe prandaj nuk shqetësohej.

2. Ndërprerja

Njeriu i cili ndërpritet, teksa është plotësisht i zhytur në një punë të rëndësishme e interesante, e ndien dhe shprehet për këtë. Madje cicërimat e një zogu, gumëzhima e një mize, apo zukatja e një mushkonje, i acarojnë aq shumë disa njerëz sa

hidhen menjëherë në zemërim. Ata reagojnë në të njëjtën mënyrë edhe kur zgjohen nga gjumi.

3. Muhabetqarë të bezdisshëm

Disa njerëz janë muhabetqarë të mëdhenj. Ata mund të flasin për orë të tëra pa pushim dhe shpesh bisedat e tyre janë të bezdisshme dhe jo konstruktive. T'u japësh kohë dhe vëmendje këtyre njerëzve përgjithësisht është e vështirë dhe kërkon qetësi dhe takt nga ana e dëgjuesit, i cili mund të ashpërsohet ose të shpërthejë në indinjatë, madje deri në fyerje të rëndë ndaj folësit.

4. Ushqimi

Ushqimi shpesh është shkaku i nervozizmit. Fëmijët e uritur e shprehin këtë më së miri. Shumë bashkëshortë i qortojnë gratë e tyre nëse ushqimi nuk është përgatitur në kohë apo nuk është gatuar ashtu siç e duan ata. Uria acaron nervat e personave, gjë që sjell në mënyrë të pashmangshme rritje të nervozizmit, sidomos tek ata që nuk janë mësuar me agjërim. Prandaj të gjithë duhet

të kemi kujdes kur uria murmurit në stomakun tonë.

5. Vështirësitë financiare

Shumë probleme shpesh shkaktojnë stres të madh mendor, i cili si rrjedhojë sjell acarim, humbje të gjallërisë dhe të ndjenjës së mirëqenies. Qetësia shpirtërore është qëllimi ynë, andaj është thellësisht e nevojshme që të mos lejojmë që problemet financiare të trazojnë ekuilibrin e qetësisë sonë shpirtërore. Ne duhet t'i përmbahemi fort bindjes dhe besimit në Zot dhe të jemi mirënjohës që nëpërmjet Islamit, ne zotërojmë pasuri të pavdekshme që vlejnë më shumë se çdo gjë tjetër që ekziston në këtë botë.

Shpirti i qetë i mundëson njeriut që të përjetojë harmoni të hijshme e të hareshme, pavarësisht kushteve jo të favorshme financiare.

6. Lodhja

Zakonisht, një person i rraskapitur nuk është në humor të mirë dhe nervat e tij janë në kufij. Kështu, ai lehtësisht mund të bezdiset. Lodhja

është një sinjal për udhëtarin shpirtëror, që të jetë i vëmendshëm dhe të jetë mjaft i kujdesshëm ndaj fjalëve dhe veprave të tij.

7. Abuzimi, shpifja dhe sarkazma

Këto janë armë verbale që përdoren nga disa njerëz keqdashës, që duan të poshtërojnë, përgojnë ose përqeshin persona të tjerë. Njeriu që me zell kërkon të kultivojë qetësinë shpirtërore, duhet të mësojë të qëndrojë i qetë dhe i përmbajtur nën praninë e kundërshtarëve të tij. Për këtë kërkohet një gradë e lartë e vetëkontrollit, dhe ai që është i vendosur për ta perfeksionuar veten, sigurisht që do të arrijë objektivin e tij.

Sa herë që njeriu gjendet në ndonjërin prej situatave të lartpërmendura, ai duhet të veprojë menjëherë për të mbrojtur veten nga ndikime të kundërta që mund ta shtynë për të humbur disi harmoninë shpirtërore. Këto janë çaste, në të cilat ai duhet të tregohet i qetë dhe i përmbajtur, dhe sa herë

që fiton në këtë përpjekje, shton nga një gur në kështjellën e tij shpirtërore, derisa përfundimisht natyra dhe sjellja e tij e përgjithshme bëhet jashtëzakonisht tërheqëse.

Janë qindra lloj gjërash të vogla në jetë, që mund ta trazojnë njeriun.

Mospranimi i diçkaje është më se normale, por një reagim i papërmbytur është krejtësisht jonormal. Ajo që e bezdis A-në, ndoshta nuk e shqetëson B-në, dhe ajo që i ngjall neveri B-së, nuk sjell asnjë reagim tek A-ja. Në vazhdim vijon një listë veprimesh të ndodhive të përditshme, që synojnë të provojnë vetëpërmbyajtjen dhe durimin e një individi. Ato nuk duhen parë përciptas e me cektësi. Ata që i trajtojnë me shkujdesje, do të jenë të parët për t'u rrëzuar para sfidës. Ndërsa ata që janë të singertë, do të vlerësojnë rëndësinë e tyre, dhe çastin që do të dalin para situatave të tilla, do t'i përmbahen qetësisë dhe vetëpërmbyajtjes.

Kur njerëzit nuk kanë asnjë respekt për përpikërinë.

Kur humbni diçka me vlerë.

Kur ju porositeni për të bërë diçka që nuk ju pëlqen apo nuk doni ta bëni.

Kur njerëzit hyjnë në hasmëri me ju.

Kur sapo keni humbur trenin apo autobusin.

Kur dikush ju shkel në besë.

Kur ju derdhni një bidonë me bojë apo kuti qumështi etj.

Kur jeni paqejf, apo kur ndieni dhimbje të forta në trup.

Kur kujtoni që të tjerët sillen padrejtësisht me ju.

Kur njerëzit nuk ju japin respektin që meritoni.

Kur njerëzit nuk veprojnë sipas dëshirës suaj.

Këtu mund të shënohen një mori situatash. Ashtu siç ushtrimet fizike forcojnë muskujt e trupit, po kështu ushtrimet mendore e shpirtërore zhvillojnë mendjen e shpirtin. Arritja e një objektivi qoftë material a shpirtëror kërkon vëmendje të vazhdueshme, ndjekur nga një vullnet i pathyeshëm.

Dëshira bashkë me mendime të përqendruara në objektivin e synuar, rezulton me arritjen e dëshiruar.

Oqeanit të paqes shpirtërore nuk i

gjendet fundi. Paqja shpirtërore është një perlë me vlera të pallogaritshme, e cila mund të fitohet dhe të zotërohet vetëm nga ai njeri, që ushqehet nga një dëshirë e zellshme dhe që përqendron mendjen e tij vetëm në përmbushjen e këtij qëllimi. Ai e këqyr sjelljen e tij në mënyrë të vazhdueshme me një vëmendje të kujdesshme dhe i lutet Zotit për ta ndihmuar që të arrijë objektivin e tij të bekuar. Kjo gjë duket edhe në këtë ajet të kuranit që thotë:

“O shpirt i qetësuar, kthehu te Zoti yt. Ti je i lumtur me Të, dhe Ai me ty. Pra, hyr mes robërve të Mi, hyr në parajsën Time.” (Kurani 89:28-31)

Prandaj duhet të jetë e qartë se gjendja më e lartë shpirtërore e njeriut në këtë jetë është që ai të ketë përkrahjen e plotë të Zotit dhe e tërë kënaqësia, gëzimi dhe lumturia e tij duhet të përqendrohet dhe të sillet rreth Zotit. Kjo është ajo gjendje që me fjale të tjera quhet jetë hyjnore. Në këtë gjendje njeriut, po në botën tokësore, i jepet një jetë hyjnore, e cila është shpërblim i vërtetësisë, besnikërisë dhe dëlirësisë së tij.

Njerëzit e tjerë presin parajsën e premtuar, kurse ky në këtë jetë hyn në të.

Shënime

- a (UNODC, World Drug Report 2012, ISBN: 978-92-1-148267-6 f. III, http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/WDR2012/WDR_2012_web_small.pdf)
- b (<http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs349/en/index.html>)
- c American Journal of Preventive Medicine, Vëll. 45, nr. 4, f. 474-485 Artikulli i detajuar mund të lexohet në linkun e mëposhtëm. <http://download.journals.elsevierhealth.com/pdfs/journals/0749-3797/PIIS0749379713003735.pdf>)
- d. <http://www.forbes.com/sites/afontevetchia/2012/12/06/can-online-poker-save-zynga-417b-global-gambling-market-throws-pincus-a-risky-lifeline/>
- e burimi: <http://www.cnn.com/id/43628943/page/0>

Markelian Shparthi



Xhemati Musliman Ahmedia në Gjermani merr statusin e një shoqërie me të drejta publike

Islami në Gjermani po shënon histori. Një komunitet musliman për herë të parë merr statusin e një shoqërie me të drejta publike në një shtet të Gjermanisë. Xhemati Musliman Ahmedia, komuniteti musliman reformues më i madh në botë me dhjetëra miliona anëtarë të bashkuar në dorën e një udhëheqësi, është bashkësia e parë fetare muslimane në Gjermani, së cilës i jepet statusi “Shoqëri me të drejta publike” (Körperschaft des öffentlichen Rechts) në shtetin Hesse.


- Xhemati Musliman Ahmedia i Gjermanisë është një nga

bashkësitë me të mëdha Islame, aktualisht me mbi 35.000 anëtarë, me mbi gjashtë dekada, e paraqitur në Gjermani. Në gjithë vendin, Xhemati Musliman Ahmedia ka 39 xhami me minare dhe kupola, ndër to edhe xhamitë e para të ndërtuara pas luftës së Gjermanisë në Hamburg (1957) dhe Frankfurt (1959).

- Xhemati Musliman Ahmedia në 2012 ka hapur në tërë Gjermaninë të parin “Institut për teologjinë Islame dhe studimet krahasuese të feve”, për shkollimin gjithëpërfshirës të teologëve në Riedstadt, Hesse.
- Gjithashtu, përgjatë vitit shkollor 2013-14, si një partner i shtetit të Hesse-it, ai do të ofrojë mësimin e Islamit nëpër shkollat fillore.
- Mbledhja më e madhe, e rregullt e muslimanëve në Evropë (30.000 pjesëmarrës), organizohet për çdo vit nga Xhemati Musliman Ahmedia

në Karlsruhe, (mbledhja e fundit u mbajt në datat 28-30 qershor të vitit 2013, ndërsa mbledhja e ardhshme do të jetë më 13-15 qershor 2014).

Bashkëjetesa e besimit me ligjin e shtetit është një realitet i gjallë për muslimanët ahmedianë. Angazhimi ynë i plotë për mbarëvajtjen e rendit shtetëror dhe të demokracisë së lirë është i bazuar në mësimet e Islamit, ashtu siç na është treguar nga Profeti i shenjtë Muhamedi (sa) dhe na është paraqitur në këtë kohë nga Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu Hazret Mirza Ghulam Ahmed Kadijani (as). Sigurisht ky fakt u ka ndihmuar autoritarëve të Hesse-it për vendimmarrjen në favor të një partneriteti të barabartë në formën e KdöR-it. Këtë titull ligjor, ne si bashkësi (Xhemat) e ndiejmë si njohje të përpjekjeve tona të vazhueshme për të mirën e përbashkët dhe të pjesëmarrjes sonë në diskursin publik.



Xhemati Musliman Ahmedia në Afrikë

Një poster me portretin e Hazret Mirza Ghulam Ahmedit ^{a.s.}, në rrugën kryesore të Kasoa-së, në zonën qendrore të Ganës.

Foto nga: Umar Safir

1 20 vjet përpara, në një fshat të vogël e të largët të Panxhabit të Indisë, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi a.s. bëri një deklaratë të jashtëzakonshme, se ai ishte Mesihu i Premtuar, i parashikuar nga shkrimet e shenjta të feve të ndryshme dhe Imam Mehdiu i shumëpritur nga muslimanët.

Fillimisht kur bëri deklaratën e tij, ai nuk njihej, as nuk kishte mjete dhe kishte përpara një mision që dukej thuajse i pamundur. Shumica e muslimanëve dhe të krishterëve e kundërshtuan ashpër. Megjithatë, ai deklaroi se do të ngadhënjente patjetër në misionin e tij për të ringjallur mësimet e vërteta të Islamit, për të rinuar besimin e muslimanëve dhe për të bashkuar njerëzimin që të adhurojë Një Zot të Vetëm. Ai gjithashtu deklaroi se do të gëzonte sukses jo me “shpatë”, por vetëm me dialog paqësor, lutje, arsye dhe argumente të pakontestueshme. Ai njoftoi se *Zoti i kishte premtuar duke thënë:*


Ai njoftoi se Zoti i kishte premtuar duke thënë: “Unë do ta çoj mesazhin tënd deri në skajet e botës”.

“Unë do ta çoj mesazhin tënd deri në skajet e botës”.

Gjatë këtyre 120 viteve, Xhemati Musliman Ahmedia, Xhemati që ai themeloi, lulëzoi dhe arriti të bëhej bashkësia muslimane më dinamike në botë, e themeluar tashmë në 204 vende të botës. Vetëm në Afrikë, miliona njerëz ndjekin Islam

Ahmediatin, ndërsa dhjetëra milionë të tjerë e quajnë veten ndjekës besnikë të saj.

Deri më sot Xhemati Musliman Ahmedia ka ndërtuar qindra shkolla, spitale e xhami në shumë vende lindore e perëndimore të Afrikës. Në shumë vende të këtij kontinenti, arkitektët ahmedianë vullnetarisht gërmuan e instaluan pompa uji, duke u shërbyer për hir të Zotit njerëzve afrikanë, të cilët kurrë më parë nuk kishin patur ujë të pijshëm në fshatrat e tyre. Vetëm gjatë vitit të kaluar, 256 pompa uji janë instaluar në kontinentin afrikan nga arkitektët ahmedianë (shoqata IAAAE), ndërsa deri më



Hazret Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar duke bërë lutje në Xhalsa Salanën (Mbledhjen Vjetore) e Ghanës

Allahu e ndihmoftë fuqimisht, duke folur për ndërtimin e xhamive në Afrikë e në Indi, thotë:

tani janë instaluar gjithsej 1094 pompa uji. Për Xhematin Musliman Ahmedia, shërbimi ndaj njerëzimit pa dallim race, kombi a feje, është jo vetëm pjesë e besimit, por edhe objektivi kryesor i praktikës së tyre.

Në fjalimin e tij të xhumasë, të mbajtur më 3 janar 2014, Hazret Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar,

“Vetëm gjatë vitit 2013, me bekimin e Allahut të Madhërishëm, Xhemati ka ndërtuar 136 xhami të mirëfillta. Në Indi janë ndërtuar edhe xhami të përkohshme me dhoma apo salla që kanë çati prej druri ose llamarine. Kjo për shkak të nevojës së ngutshme që ekzistonte në ato vende. Të tilla xhami janë ndërtuar 22. Përveç këtyre, Xhemati gëzoi 258 xhami të



reja. Xhemati i gëzoi do të thotë se, në shumë vende, përmes përhapjes së mesazhit të Xhematit, bashkë me njerëz të ndryshëm e kanë pranuar Xhematin edhe imamët e tyre dhe bashkë me imamët edhe xhamitë e tyre erdhën në Xhemat. Siç ju tregova, më shumë punë është bërë në Afrikë dhe në Indi. Për xhamitë që fola pak më herët, 102 prej tyre janë ndërtuar në Afrikë. Përveç kësaj, po në Afrikë 41 xhami të tjera janë nën ndërtim. Edhe në vende të tjera janë ndërtuar dhe po ndërtohen xhami. Në të njëjtën

Pamje e një Mbledhjeje Vjetore të Xhematit Musliman Ahmedia të Ghanës gjatë vitit 2008.

mënyrë vijon edhe ndërtimi i shtëpive të misionit. Gjatë vitit të kaluar janë ndërtuar 121 shtëpi misioni, 77 prej të cilave janë ndërtuar në Afrikë, ndërsa 5 në Indi. ... Në Afrikë, Xhemati ynë po përhapet më shumë në 7-8 vende të pjesës lindore e perëndimore. Elhamdulillah, po bëhet mjaft punë atje”.

Pyetje-përgjigje (diskurs)

Parimet e interpretimit të ëndrrave



Ky është transkriptimi i një sesiioni pyetje-përgjigjesh të mbajtur nga Hazret Mirza Tahir Ahmedi, Kalifi i IV i Mesihut të Premtuar ^{Allahu e mëshiroftë}. Ky sesion u mbajt më 8 dhjetor të vitit 1995.

Pyetja:

Cilat janë parimet kryesore të interpretimit të ëndrrave?

Përgjigjja:

Së pari, interpretimi i ëndrrave është një dhunti prej Zotit të Lartësuar. Profeti Jusuf a.s. njihet si më famëmadhi për

interpretimin e ëndrrave. Por, derisa Zoti nuk ia mësoi, ai nuk e kishte kuptuar as kuptimin e ëndrrës së vet. Babai i tij që gjithashtu ishte profet, e këshilloi atë që të mos ia tregonte ëndrrën të tjerëve, përndryshe ata do ta dëmtonin. Pra, dikur ishte gjendja në të cilën ai nuk e kuptonte ëndrrën që kishte parë vetë dhe, në një moment të caktuar, vjen koha kur Zoti pohon:

“Ne ia kemi mësuar interpretimin e ëndrrave”.¹ Më pas jeta e tij ndryshon tërësisht.

Kështu që, ka shumë njerëz, të cilët Zoti i Lartësuar ua jep këtë si dhunti. Nganjëherë kjo ka të bëjë edhe ndërtimin e trurit të njeriut, në ato raste kur kjo aftësi nuk vjen si dhuratë e veçantë prej Zotit apo si një bekim shpirtëror prej Tij. Ashtu siç çdo njeri ka aftësi të ndryshme, disa gjëra shkëlqejnë më shumë te disa njerëz. Edhe aftësia e të interpretuarit të ëndrrave është ndër dhuntitë që shkëlqejnë te disa njerëz më shumë e te disa më pak. Dikush krahët i ka të fortë, dikush këmbët, dikush trurin e ka të mprehtë e dikush diçka tjetër. Kështu që, ato pjesë të trurit që kanë lidhje me ëndrrat, kam vënë re që te disa njerëz janë shumë të mprehta. Njerëzit që më shkruajnë ëndrrat e tyre, disa prej tyre shkruajnë edhe interpretimet. Disa interpretime duken se janë krejtësisht pa lidhje, por disa njerëz i interpretojnë aq saktë, sa befasonesh. Pra, në këtë mënyrë kjo aftësi i vjen njeriut si një dije e veçantë prej Zotit të Lartësuar dhe kjo është si një dritë që është në trurin e njeriut. Prandaj, kjo nuk është diçka që mund

t’ju vijë artificialisht. Përveç këtyre dy pikave, ata që dëshirojnë të zhvillojnë aftësinë e tyre të të interpretuarit të ëndrrave në mënyrë shkencore, duhet t’u përmbahen disa parimeve, që do t’ju tregoj në vijim:

Së pari, ka shumë ëndrra që prodhon vetë *nefsi* i njeriut, madje shumicës së njerëzve këto lloj ëndrrash u vijnë. Për këtë arsye, duhet të bëjmë një dallim midis ëndrrave të *nefsit* dhe ëndrrave të tjera. Njëri prej treguesve të këtij dallimi është vetë natyra e atij njeriu që sheh ëndrrën. Kur Zoti të dërgon ndonjë ëndërr, befasoneni sesi shihni ato gjëra që nuk i kishit në asnjë skaj të mendjes. Psikologët mund të thonë se kjo nuk është ndonjë ëndërr prej Zotit, por ishin mendimet që gjendeshin në nënndërgjegjen tuaj, e cila jua ka shfaqur në këtë formë. Nganjëherë njeriu sheh ndonjë ëndërr krejtësisht të pazakontë, pasi edhe njeriu vetë nuk e njeh në mënyrë gjithëpërfshirëse nënndërgjegjen e tij. Kjo është e mundur. Por, po ashtu, është e mundur që Zoti i Lartësuar, duke përdorur informacionet e nënndërgjegjes suaj, t’ju japë ndonjë mesazh. Duke i njohur këto dy mundësi, duhet të dimë se si të bëjmë dallimin.

1 Kurani Famëllartë 12:7

Një gjë që duhet të kemi parasysh se ata që gënjejnë, edhe ëndrrat shpesh i shohin të rreme. Kurse ata që janë të drejtë e të sinqertë, as nuk thurin ëndrra të rreme, as ëndrrat e tyre nuk përbëhen prej brumit të gënjeshtërs. Kështu që, vetë pastërtia shpirtërore e njeriut dhe sinqeriteti i tij, ndikon në ëndrrat dhe në interpretimin e tyre. Nganjëherë ndodh që një njeri i drejtë të shohë një ëndërr aq të frikshme, saqë të kujtojë se do të shkatërrohet. Fillon të mendojë se çfarë po ndodh me të. Ndërsa, një interpretues kur ia dëgjon ëndrrën, bën interpretimin që e ngre akoma më shumë në status. Po ashtu ndodh që një njeri gënjeshtar shoh ëndrra të bukura e të lavdishme për veten dhe ëndërron që do të jetë i shpëtuar, banor i xhenetit, madje dikush deklaron të jetë Mesih, e dikush tjetër bën ndonjë deklaratë tjetër. Por, natyra e atij njeriu do t'ju dëshmojë ndryshe. Pastaj, duhet parë edhe mundësia e ndonjë sëmundjeje tek një person i tillë. Pra, nëse ka kontradiktë midis natyrës së njeriut dhe ëndrrës së tij, atëherë kjo në vetvete është një dëshmi që ëndrra e tij nuk është e vërtetë. Mesazhi i tij është i rremë. Në Afrikë disa njerëz kur sëmuren, pretendojnë të bëhen të dërguar prej Zotit. Dikur

njëri kishte deklaruar që ishte Mesih. I thashë: A nuk e njeh jetën e Mesihut të Premtuar a.s. se me çfarë përlusie ai ka kaluar gjithë jetën?! Vazhdimisht merrte mesazhet prej Zotit, por nga përlusia i interpretonte duke mos e vlerësuar veten. Më në fund, ai u detyrua ta pranonte. Përveç kësaj, ai kishte plot aftësi të tjera mesaikë që u bënë shenjë e vërtetësisë së tij. Shumë njerëz që lëngonin për vdekje janë shëruar nga lutjet e tij dhe gjithashtu ai solli një oqean dijesh prej Zotit. E pyeta atë afrikanin: Më tregoni se çfarë shenjash keni sjellë ju? Më tregoni vetëm një. Më tregoni ndonjë parashikim për të ardhmen. Më tregoni ndonjë bëmë tuajën lidhur me dijen, spiritualitetin. Çfarë keni bërë duke qenë Mesih në këtë botë? Ai mbeti i shtangur. Asnjë gjë nuk kishte ai. Kështu që, jo vetëm gënjeshtar i sjellin ëndrra të rreme, por nganjëherë edhe sëmundja e shkakton këtë gjë tek njeriu. Një njeri që është i sëmurë psikik dhe njëkohësisht shoh ëndrra, të cilat ia tregojnë veten të lartë, në një kohë kur ai nuk ka asnjë shenjë dalluese, as nuk ka dijen e Kuranit, të haditheve, e as nuk posedon kuptimet e thella të fesë, por pretendon që është dërguar si reformator i kohës, atëherë

ëndrrat e tij na bëjnë të nxjerrim vetëm dy përfundime: ose është i sëmurë, ose është gënjeshtar. Nuk mund të ketë ndonjë përfundim të tretë. Për të interpretuar ëndrrat, patjetër duhet të kemi parasysh karakterin e njeriut, sepse këto dy gjëra duhet të përputhen me njëra-tjetrën, vetëm atëherë interpretimi mund të jetë i saktë.

[...] Ndërsa ëndrra që tregon Zoti i Lartësuar, do të ketë disa kode të cilat nganjëherë, edhe ai që ka parë ëndrrën nuk i zbërthen dot. Ashtu siç edhe Profeti Jusuf a.s., me shumë thjeshtësi, e kishte pyetur të atin e vet: “O baba! Kam parë në ëndërr hënën dhe yjet duke më bërë *sexhde*”. Ndërkohë, natyra e Profetit Jusuf a.s. nuk pranonte një gjë të tillë, pra ai as nuk mund ta imagjinonte atë. Kur nuk e kuptoi kodin e ëndrrës, pyeti një njeri të ditur, dhe nuk është e thënë që ai që nuk e kupton ëndrrën e tij, patjetër të jetë një njeri i paditur. Disa herë edhe dijetarë të mëdhenj nuk arrijnë të kuptojnë tërësisht ëndrrën e tyre, sepse ajo nuk është krijimtaria e tyre, por u vjen prej Zotit. I tillë është edhe rasti i Hazret Imam Ebu Hanifasë r.a., që kishte parë veten e tij në ëndërr, duke gërmuar varrin e Profetit Muhammed

s.a.v.s. dhe më pas disa nga eshtrat e Profetit s.a.v.s. i pëlqente dhe disa nuk i pëlqente dhe i mënjanonte ato. Kjo ëndërr atij i ra si një termet. U frikësua shumë nga kjo se nuk po e njihte më veten se çfarë njeriu ishte. I famshëm Ibni Sirini që ai që ia interpretoi ëndrrën. I tha: *Urime! Jeni jurist (fëkih) i shkëlqyer. Zoti jua ka dhënë këtë dije. Gjatë jetës suaj, do të interpretoni thëniet e Profetit Muhammed s.a.v.s. ndërsa ato gjëra që janë quajtur si thëniet e tij, por nuk rezultojnë të tilla, do t'i mënjanoni.* Sa i lartë ishte ky interpretim! Ndër interpretuesit, ndoshta Ibni Sirini është më i denjë për ju që t'i studioni interpretimet e tij. Kjo, nëse dëshironi të mësoni ndonjë mënyrë për interpretimin e ëndrrave. Të tjerat jua kam treguar më parë.

Edhe një gjë është me vlerë të përmend këtu. Interpretimi mban ndonjë shenjë me vete, e cila kur përmbushet, dëshmon që edhe ëndrra ishte e vërtetë, edhe interpretimi ishte i vërtetë. Realisht, mesazhi prej Zotit të Lartësuar nuk vjen pa pasur ndonjë shenjë me vete, herë të shprehur haptas e herë fshehtas. Për shembull, Hazret Jusufi a.s. kishte interpretuar ëndrrën e mbretit, interpretim i cili kishte lidhje

me ngjarjet që do të zhvilloheshin gjatë shtatë a tetë viteve të ardhshme, ndërkohë që, gjatë kohës kur ishte parë ëndrra, nuk dukej asnjë shenjë. Ajo ëndërr i kishte ardhur mbretit, sepse ai ishte përgjegjës për popullin e tij, për kujdesin ndaj njerëzve të kombit të tij. Prandaj, Zoti i Lartësuar atij ia kishte shfaqur këtë ëndërr. Po t'ia tregonte dikujt tjetër, mbreti nuk do të merrte masa. Me një fjalë, gjithë mesazhi do të shkonte kot. Kështu që, gjërat që do të zhvillohen më vonë, gjatë shtatë apo tetë viteve, dëshmojnë që edhe ëndrra ishte e vërtetë, edhe interpretimi i saj ishte i vërtetë. Pra, edhe kjo është një mënyrë për të kuptuar ëndrrën. Nëse shihni ndonjë ëndërr dhe vetë shpejt e shpejt nxirrni ndonjë interpretim, i cili më vonë del i gabuar, këtë vetë do ta kuptoni. Por nëse ëndrra është e çuditshme, pra ajo nuk ka ndonjë lidhje me ëndërrshikuesit dhe është jashtë kapaciteteve të qenies së tij, atëherë edhe ky është një tregues që qartëson se ëndrra është e vërtetë.

Nëse doni të mësoni si interpretohen ëndrrat, e kam fjalën nëse doni të mësoni ashtu siç mësohen librat në shkollë, metoda më e mirë është ajo e Ibni Sirinit. Për çdo gjë, ai jep

mundësi të ndryshme. Nëse keni parë në ëndërr dhëmbin, ai ju tregon që dhëmbi mund të këto këto kuptime. Bie fjala, nëse keni nxjerrë dhëmbin dhe e keni mbajtur në dorë, ky është bekim. Nëse do ta hidhni atë, mund të humbisni dikë nga njerëzit tuaj të dashur, etj. etj. Përveç Ibni Sirinit, ka edhe një interpretues tjetër, shit (shia) Imam Bakiri ^{r.a.}. Interpretimet e tij janë përmbledhur në një libër, i cili titullohet "*Ta'tirul enam*" dhe që tregon se Zoti i Lartësuar i kishte dhuruar dhunti dhe njohuri të veçantë në këtë fushë. Mund ta lexoni edhe atë. Mund të studioni gjithashtu ëndrrat që janë ruajtur në librat e interpretimeve, të cilat janë bërë nga interpretuesit e mëdhenj. Ose mund të mësoni edhe nga interpretimet që u ka bërë Mesihu i Premtuar a.s. jo vetëm ëndrrave të tij, por edhe ëndrrave të të tjerëve. Ky studim është mjaft interesant. Por, siç ju tregova, të interpretuarit e vërtetë është një dhunti prej Zotit. Kemi një mik, z. Sejed Naim Shah, i cili jeton këtu në Londër. [...] Një herë Hazret Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar gjendej në shtëpinë e Meher Apasë. Po drekonin bashkë në shtëpi. Ishin vendosur disa sofra. Ishte kohë e vjetër dhe shtëpitë ishin prej dheu.

Aty ishin Naimi, Vesimi dhe vëllezër të tjerë. Duke ngrënë Naimi pyeti Hazurin (Kalifin e Dytë të Mesihut të Premtuar a.s.): “Hazur! Kam parë një ëndërr. A mund të ma tregoni interpretimin?” “Çfarë keni parë?” e pyeti Hazuri. Naimi iu përgjigj: “Kam parë sikur kisha kapur një peshk”. “Peshku ishte i vogël apo i madh?”, e pyeti Hazuri. “Ishte i vogël”, u përgjigj ai. Pastaj Hazuri i tha: “Mos keni dhënë ndonjë provim tani shpejt?” Ai tha “Po”. “Do të ngelësh” i tha Hazuri. Naimi u shtang. Çfarë ishte ëndrra dhe ç’pyetje i bëri! Çfarë lidhje ka kjo? Hazret Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar sqaroi: “Peshku i madh mund ta vjellë atë që ha, prandaj, ai simbolizon një vështirësi që kalohet. Ndërsa peshku i vogël nuk e nxjerr, prandaj edhe vështirësia nuk kalohet”. Përveç kësaj, peshku interpretohet edhe si bekim, por kjo varet nga rasti. Prandaj Hazret Kalifi i Dytë r.a. e pyeti paraprakisht atë, në mos kishte dhënë ndonjë provim. Pastaj i tha që do të ngelej, dhe me të vërtetë ai ngeli në provim, edhe pse ishte i gëzuar që kishte shkruar bukur. Kështu që, kjo është një dhunti që nuk mund të arrihet vetëm duke mësuar. Megjithatë, studimi i saj ju ndihmon sadopak.

(Folëm për peshkun.) Peshku ka edhe kuptime të mira. Ai simbolizon edhe spiritualitetin. Për shembull, në Kuranin Famëlartë është përmendur një vizion (*keshf*) i Hazret Musait a.s., në të cilin ai parashikon se kur do të marrë fund spiritualiteti i krishterimit. Në vizionin e tij ai sheh që peshku i tyre u ikën kur ata afrohen te vendi ku bashkohen dy dete. Në këtë vizion peshku ishte ushqim shpirtëror dhe tregonte se dikur do të mbaronte ai ushqim. Duke qenë se të krishterët, pra, shumica prej tyre, gjuanin peshq, simboli i ikjes së peshkut për të treguar gjendjen e tyre, ishte shumë i gjetur. Ky ishte një vizion. Por, edhe vizionet interpretohen siç interpretohen ëndrrat. Vizioni i tij tregonte: *ju keni mbërritur te deti i Profetit Muhammed s.a. dhe deti juaj ka mbaruar. Prandaj, peshku juaj shpirtëror ju ka ikur. Mund ta vazhdoni udhëtimin, por pa ushqimin tuaj shpirtëror. Pra, të interpretuarit është një çështje shumë e gjerë, dhe njeriu vazhdimisht duhet t’i shohë gjerësisht të gjitha pikat e saj.*

*(Marrë nga e përjavshmja “Alfazl” 21-
27 shkurt, 2005, Londër)*

Index in English

Three Stages of Kindness & Wickedness

The Commentary of the Holy Quran

by Hazrat Mirza Mahmud Ahmad Khalifatul Masih II^{r.a.}4

“Do not go towards prohibited things!”

Hadith of the Holy Prophet^{s.a.}13

Friendship with Almighty God

From the Writings of the Promised Messiah^{a.s.}16

The Path to Peace – Just Relations Between Nations

Historic Address of the Head of the Ahmadiyya Muslim

Community Delivered in the Capitol Hill, Washington

D.C. on 27th June 201218

Holy Prophet Muhammad^{s.a.} Through the Eyes of Intellectuals34

Religious Freedom of Hazrat Omar^{r.a.}

A Historical Account44

The Key to Peace – Global Unity

Historic Address by Hazrat Mirza Masroor Ahmad^{a.b.a.}, Khalifatul Masih V, Head
of the Worldwide Ahmadiyya Muslim Community, at the European Parliament in

Brussels, Belgium on 4th Dec. 201248

How to Achieve Peace Within Oneself?74

Ahmadiyya Muslim Jamaat in Germany Receives

the Status of a Society with Public Rights84

Ahmadiyya Muslim Jama'at in Africa86

Principles of Interpretation of Dreams

Transcription of a Q & A session with Hazrat Mirza Tahir Ahmad^{r.a.},

Khalifatul Masih IV, which took place on 8 Dec. 199534

PORTALI I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA NË SHQIP

www.alislam.al

بسم الله الرحمن الرحيم

In the name of Allah, Most Gracious, Most Merciful



Ahmadiyya Muslim Community
Albania

Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd

Kreu Lajmet Blog Islami Ahmediati Biblioteka Libra Online Mediateka Kalendari i namazit Kontaktoni

3 nivele të druajtjes ndaj Zotit

Komentim i Kuranit Famëlartë

Hazret Mirza Masrur Ahmed – Udhëheqësi ynë i tanishëm



Lideri botëror për paqe

Lexoni më shumë rreth Hazret Mirza Masrur Ahmetit dhe aktiviteteve të tij për vendosjen e paqes, duke spikatur bashkimin dhe vëllazërinë në mbarë botën.

Fjalimi i fundit i xhumasë, i mbajtur nga Udhëheqësi ynë botëror



28.02.2014 2014

"Konferencë e feve të gjalla"
Hazret Mirza Masrur Ahmed

Lajme dhe blog



27.02.2014 Besimi, Blog

Si e pranova Xhematin Musliman Ahmedia? – Dijetari arab Hani Tahir

I nderuari Hani Tahir është një ndër dijetarët arabë të Xhematit Musliman Ahmedia, i cili u anëtarësua në vitin 1999 dhe ia pë...

Ditari i eventeve



18.02.2013 Jalsa Salana

Xhelsa Salana e 5-të e Shqipërisë

Me mëshirën e Zotit të Lartësuar, Xhemati Musliman Ahmedia më 8 tetor 2012, zhvilloi xhelsën (tubimin vjetorë) e tij të pestë në X...

Botime të fundit



Jeta e Muhammedit (sa)

Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed (ra)



Hadithe të zgjedhura

Botim i Xhematit Musliman Ahmedia të Kosovës

Dashuri për të gjithë urrejtje për askënd

www.alislam.al



“Vërtetësia” (The Truthfulness) is a periodical Albanian magazine published by Ahmadiyya Muslim Jama’at of Albania.
For index in English, see page 96.
